



## MARATONOMAKU I 111-VJETORIT TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

FAQE 12



### AKTUALE



**STOLTENBERGU: NATO DO TË BËJË ATË QË DUHET PËR TA SIGURUAR STABILITETIN NË BALLKAN** F. 2

**BORRELLI THOTË SE DO TË VAZHDOJNË TË SIGUROJNË STABILITET NË VERI TË KOSOVËS** F. 6

**DITA E FORCËS: FSK-ja HAP DYERT PËR QYTETARËT** F. 3

### EKONOMI



**KOSOVA NUK PO BËN MJAF TUESHËM PËR TA ZVOGËLUAR VARËSINË NGA THËNGJILLI** F. 7

**"JAVËT E BIZNESIT KOSOVAR 2023", THIRRJE PËR KONSUMIM TË PRODUKTEVE VENDORE** F. 7

### SPORT



**'DARDANET' ME OPTIMIZËM E PRESIN DUELIN NDAJ BULLGARISË**

F. 10

INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-SË SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (10) | FAQE 4-5

## UNIFORMA E SATRAPIT DHE KOSTUMI I DEMOKRATIT

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së dhjetë, ka folur për përmbysjen e regjimeve komuniste në kontinentin evropian dhe shpartalimin e Bllokut Socialist që nxori në shesh krimet monstruoze që ishin bërë gjatë sundimit të tyre. Ai ka theksuar se duke qenë në të gjitha strukturat e pushtetit dhe duke pasur monopol edhe në mediet e kontrolluara prej tyre, komunistët e shfrytëzuan kontekstin e ri për t'i hequr "uniformat e satrapit" dhe për ta veshur "kostumin e demokratit". Bardhyl Mahmuti ka pohuar se gjatë kohës së shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë, "terrorizmi me motive fetare" ishte kualifikimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
+389 44 487 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Nxirren të gjithë punëtorët e ngjuar në një tunel në Indi para dy javëve

New Delhi, 28 nëntor - Ekipet e shpëtimit i kanë nxjerrë të gjithë 41 punëtorët e ndërtimit të cilët kishin mbetur të ngjuar në një tunel bjeshkor në Indi, pas shembjes së tij para dy javëve.

Qeveria e Uttarakhand, shtetit verior të Indisë, tha se janë shpëtuar të gjithë punëtorët e ngjuar brenda tunelit Silkayara për 17 ditëve. Tërheqja e tyre nisi gjashtë orë

pasi ekipet e shpëtimit e hapën një korridor për të arritur te burrat që u ngjuan më 12 nëntor kur tuneli u shemb.

Ambulancat janë parë të radhitura në hyrje të tunelit, për t'i transportuar punëtorët në spitalin që ndodhet rreth 30 kilometra larg.

Të ngjuarit ishin pajisur me ushqim, ujë, drita, oksigjen dhe ilaçe përmes një tubacioni, por ekipet e shpëtimit kishin hasur

në shumë pengesa për ta hapur një rrugë për t'i shpëtuar ata.

Tuneli është pjesë e një autostrade me kosto 1.5 miliard dollarë, që është njëra prej projekteve më ambicioze të kryeministrit të Indisë, Narendra Modi.

Autoritetet nuk kanë treguar se çfarë e kishte shkaktuar shembjen, por ky rajon goditet shpesh nga rrëshqitjet e dheut, tërmetet dhe vërshimet.



## Erdogani thotë se Izraeli duhet të gjykohet për "krime lufte" në Gazë

ANKARA, 28 NËNTOR - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, i ka thënë të martën sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Antonio Guterres, se Izraeli duhet të mbahet përgjegjës nga gjykatat ndërkombëtare për "krimeve të luftës" në Rripin e Gazës, tha Presidenca turke.

Izraeli e ka kryer një ofensivë ajrore dhe tokësore kundër Hamasit - grupit radikal palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Gazë, ku si pasojë kanë vdekur më shumë se 15 000 njerëz, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë, e cila kontrollohet nga Hamasi.

Izraeli i shpalli luftë Hamasit pasi luftëtarët e grupit radikal e kryen një sulm tronditës në Izrael më 7 tetor, ku i vranë më shumë se 1 200 njerëz dhe i rrëmbyen 240 të tjerë.

Ofensiva e Izraelit në Gazë është ndërprerë përkohësisht të



premtën, për herë të parë prej 7 tetorit, pas një marrëveshjeje për armëpushim që pritet të skadojë të mërkurën.

Gjatë një bisede telefonike para takimit të Këshillit të Sigurimit për Gazën të planifikuar për të mërkurën, Erdogan dhe

Guterres biseduan "për pritjet e komunitetet ndërkombëtar në lidhje me sulmet e jashtëligjshme të Izraelit", për qasjen në ndihma humanitare në Gazë dhe për përpjekjet për një paqe afatgjate, tha Presidenca turke. "Presidenti Erdogan tha gjatë bisedës

telefonike se Izraeli po vazhdon paturpësisht t'i shkelë ligjin ndërkombëtar, ligjet e luftës dhe ligjin humanitar ndërkombëtar duke e shikuar në sy komitetin ndërkombëtar dhe se duhet të mbahet përgjegjës për krimet që i ka kryer para ligjit

ndërkombëtar", thuhet në njoftim.

Ministria e Jashtme e Turqisë tha se ministri i Jashtëm Hakan Fidan do të marrë pjesë në takimin e Këshillit të Sigurimit të OKB-së në Nju-Jork.

Turqia e ka kritikuar ashpër luftën e Izraelit në Gazë dhe ka bërë thirrje për armëpushim të menjëhershëm për të mundësuar mbajtjen e bisedimeve për një zgjidhje me dy shtete të konfliktit të gjerë izraelit-palestinez.

Erdogani i ka quajtur gjenocid sulmet e Izraelit në Gazë. Izraeli i ka mohuar akuzat dhe thotë se lufta e tij në Gazë është vetëmbrojtje kundër një armiku të përbetuar për shkatërrimin e tij.

Turqia, po ashtu, i ka pritur pjesëtarët e Hamasit, të cilin se cilëson grup terrorist. Ajo e ka akuzuar edhe Perëndimin, përfshirë Spanjën dhe Belgjikën, se për bashkëfajësi për shkak të mbështetjes së tyre për Izraelin.

## Stoltenbergu: NATO do të bëjë atë që duhet për ta siguruar stabilitetin në Ballkan

Bruksel, 28 nëntor - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, shprehu shqetësimin për rritjen e tensioneve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, teksa premtoi se aleanca veriatlantike do të bëjë gjithçka në mënyrë që të ruajë stabilitetin në rajon. "Ajo që shohim atje është se tensionet po rriten. Po shoh rritje të tensioneve dhe retorikë nxitëse në Bosnjë-Hercegovinë. Kemi parë incidente të rënda dhune në Kosovë duke përfshirë sulmin ndaj paqeruajtësve të NATO-s. Janë lënduar 93 ushtarë të NATO-s, nga të cilët disa shumë rëndë. Gjithashtu kishim sulmin në Banjskë", deklaroi shefi i aleancës veriatlantike para takimit të ministrave të

Jashtëm të shteteve anëtare të martën. "NATO do të bëjë atë që është e nevojshme për të mbajtur ose për të siguruar stabilitetin në rajon, sepse kjo është e rëndësishme jo vetëm për Ballkanin Perëndimor, por për të tërë Evropën", porositi Stoltenbergu.

Shefat e diplomacive të 31 shteteve anëtare të NATO-s në takimin që po mbahet në Bruksel më 28 nëntor kanë diskutuar edhe për sigurinë në rajon.

Takimet do të vazhdojnë edhe më 29 nëntor.

Ministrja e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, përmendi se aktorët e jashtëm po tentojnë vazhdimisht të destabilizojnë rajonin. "Kjo vlen, jo vetëm për situatën në kufirin midis Kosovës dhe

Serbisë, por edhe për situatën në Bosnje dhe Hercegovinë. NATO-ja, por edhe BE-ja, është një nga garantuesit për sigurinë e Ballkanit Perëndimor", tha Baerbock.

Diskutimet në nivel të ministrave të NATO-s rreth situatës në rajon ajo i cilësoi si tejet të rëndësishme. Sipas ministres Baerbock, perspektiva e anëtarësimit të vendeve të rajonit në BE është e rëndësishme sepse ky paraqet "sigurim jetësor".

Ajo paralajmëroi se Gjermania do të dërgojë 150 ushtarë shtesë në kuadër të KFOR-it gjatë vitit tjetër.

Më 27 nëntor sekretari i përgjithshëm i aleancës ka paralajmëruar se në takim do të diskutohet mundësia e shtimit të përhershëm të



numrit të ushtarëve në kuadër të misionit paqeruajtës të aleancës në Kosovë, KFOR.

Sipas agjencisë "Associated Press", dhuna mes Kosovës dhe Serbisë ka shpërthyer dy

herë në muajt e fundit dhe vendet perëndimore kanë frikë se Rusia mund të përpiqet të nxisë telashe në Ballkan për ta larguar vëmendjen nga lufta në Ukrainë.



# Shqipëria dhe Kosova kuq e zi festojnë 28 Nëntorin

Tirana në këtë 28 nëntor u kthye në kryeqytetin e të gjithë shqiptarëve. 111-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë e shndërroi atë në epiqendrën e festimeve, të cilat sollën për herë të parë në Tiranë paradën Kuq e Zi. As shiu nuk i ndaloi qytetarët nga zona, shtete e troje të ndryshme ta përshkojnë bulevardin “Dëshmorët e Kombit” me flamurin shqiptar dhe kostumet popullore. Gjithashtu, edhe në Prishtinë me aktivitete të ndryshme është shënuar kjo datë historike dhe në të njëjtën kohë edhe dalja publike e ushtrisë sonë çlirimtare, UÇK-së, më 28 nëntor 1997. Kosova më 28 nëntor shënon edhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 NËNTOR - 111 vjet më parë në Vlorë, përfaqësues të vilajeteve shqiptare e shpallën Pavarësinë e shtetit shqiptar. Kuvendi Kombëtar i Vlorës mbledhjen e tij të parë e mbajti më 28 nëntor 1912, me aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shtetit Shqiptar nga Perandoria Osmane. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë ishte kurorëzim i përpjekjeve shekullore dhe luftërave të pareshtura që bënë shqiptarët për çlirimin e vendit. Përpos që në Kosovë festohet shpallja e shtetit shqiptar, qytetarët tanë festojnë në këtë datë edhe daljen publike të ushtrisë sonë çlirimtare, UÇK-së, më 28 nëntor 1997. Kosova më 28 nëntor shënon edhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari. Prekazi mbledhi mijëra qytetarë e krerë institucionesh që nderuan familjen Jashari. 111-vjetori i Pavarësisë së

Shqipërisë e shndërroi atë në epiqendrën e festimeve, të cilat sollën për herë të parë në Tiranë paradën Kuq e Zi. As shiu nuk i ndaloi qytetarët nga zona, shtete e troje të ndryshme të përshkojnë bulevardin “Dëshmorët e Kombit” me flamurin shqiptar dhe kostumet popullore. Në këtë bulevard parakaluan mbi përfaqësues të 150 komunave dhe bashkive nga trevat shqiptare. Ndërkaq, Vlorë këtë herë bëri bashkë edhe kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe atë të Kosovës, Albin Kurti. Dy kryeministrat, presidenti i Republikës, Bajram Begaj dhe kryeparlamentarja, Lindita, ishin pjesë e ceremonisë së përvitshme të ngritjes së flamurit dhe më pas homazheve në Monumentin e Pavarësisë. Kryeministri Kurti ua uroi të gjithë shqiptarëve 28 Nëntorin, këtë festë të madhe të flamurit e të lirisë, të pavarësisë e të bashkimit për të gjithë shqiptarët në Shqipëri, në Kosovë, kudo që janë në Ballkan,




në mërgatë e në botë. Teksa theksoi se sot është ditë pushimi dhe feste, ai nga qyteti i Vlorës tha se çdo ditë tjetër duhet të punojmë për idealin dhe synimet e Skënderbeut nga Kruja, të Ismail Qemalit nga Vlora e të Adem Jasharit nga Prekazi. “Ne ishim këtu për të bërë nderime në Vlorë me krerët institucionalë të shtetit shqiptar dhe pasdite do të jemi në Kosovë për të bërë homazhe te varrezat e Jasharëve në krye me kryekomandantin Adem Jashari”, tha kryeministri Kurti. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se 28 Nëntori, Dita e Pavarësisë së Shqipërisë, ua kujton të gjithë shqiptarëve çmimin e lartë për lirinë. Gjatë homazheve në Prekaz të Skenderajt, Osmani uroi të gjithë shqiptarët për pavarësinë e Shqipërisë, por theksoi se kjo datë lidhet edhe me ngjarje të tjera të rëndësishme për shqiptarët e Kosovës.

“Sot e fillojmë këtë ditë historike duke e nderuar një figurë dhe një familje po aq historike sa dhe vetë flamuri kuq e zi, familjen Jashari, njëkohësisht duke shënuar ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari, dhe daljen e parë publike të ushtrisë sonë çlirimtare më 28 nëntor 1997. Është pikërisht flamuri kuq e zi dhe data 28 nëntor që është ditë që na kujton gjithsecilit prej nesh çmimin e lartë të lirisë, njëkohësisht edhe sakrificat që janë bërë për shekuj në mënyrë që të jetojmë të lirë”, tha Osmani. Në homazhe në kompleksin memorial në Prekaz së bashku me Osmanin ishte edhe kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca. Ai tha se shënimi i 28 Nëntorit gjithmonë nis në Prekaz, ku më 5, 6 dhe 7 mars të vitit 1998 forcat serbe sulmuan familjen Jashari, duke lënë të vranë mbi 50 anëtarë të kësaj familjeje. “28 Nëntori në Kosovë

gjithmonë fillon në Prekaz, këtu ku ka ndodhur sakrificat më e lartë e popullit të Kosovës për liri dhe këtu ku është ngizur lufta e lavdishme e UÇK-së. Po kjo datë është dalja publike e ushtrisë sonë çlirimtare, po ashtu në të njëjtën kohë ditëlindja e komandantit legjendar Adem Jashari. Nëntorët do të festohen gjithmonë. Uroj që neve të na gjejë gjithmonë të bashkuar dhe gjithnjë më të fortë”, tha Konjufca. Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë e kanë uruar edhe liderët e tjerë politikë në Kosovë. Në Kosovë 28 Nëntori nuk është festë shtetërore, por Qeveria e Kosovës me vendim të posaçëm çdo vit e shpall këtë ditë si ditë pushimi. Gjatë kësaj dite qytetet në mbarë Kosovën stolisen me flamurin kombëtar të Shqipërisë dhe institucionet organizojnë ngjarje të ndryshme për ta shënuar këtë festë.

## Dita e Forcës: FSK-ja hap dyert për qytetarët



Prishtinë, 28 nëntor - Kazerma “Adem Jashari” në Prishtinë u mbush me qytetarë të shumtë të cilët takuan pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe panë nga afër pajisjet e tyre. Numri më i madh i vizitorëve ishin fëmijë të shkollave të ndryshme të kryeqytetit të Kosovës, Prishtinë. Ata morën pjesë në shënimin e “Ditës së Forcës” që çdo vit shënohet më 27 nëntor dhe simbolizon themelimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Kjo forcë u themelua më 1 janar të vitit 2009, pas shpërbërjes së Trupave Mbrotjtëse të Kosovës (TMK).





INTERVISTË EKSKLUZIVE ME BARDHYL MAHMUTIN: SI U HOQ CILËSIMI I UÇK-së SI "ORGANIZATË TERRORISTE"? (10)

## Uniforma e satrapit dhe kostumi i demokratit

Politologu Bardhyl Mahmuti, ish-përfaqësues politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në intervistën ekskluzive dhënë "Epokës së re", në vazhdimin e pjesës së dhjetë, ka folur për përmbysjen e regjimeve komuniste në kontinentin evropian dhe shpartallimin e Bllokut Socialist që nxori në shesh krimet monstruoze që ishin bërë gjatë sundimit të tyre. Ai ka theksuar se duke qenë në të gjitha strukturat e pushtetit dhe duke pasur monopol edhe në mediet e kontrolluara prej tyre, komunistët e shfrytëzuan kontekstin e ri për t'i hequr "uniformat e satrapit" dhe për ta veshur "kostumin e demokratit". Bardhyl Mahmuti ka pohuar se gjatë kohës së shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë, "terrorizmi me motive fetare" ishte kualifikimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar

Prishtinë, 28 nëntor -

**"Epoka e re":** Për ata që njohin historinë e rezistencës kombëtare shqiptare, epiteti "i majtë" ka hyrë vonë në arsenalin propagandistik të luftës kundër organizatave patriotike shqiptare. A mund të na thoni se kur dhe nga kush keni filluar të cilësoheni si "të majtë"?

**Bardhyl Mahmuti:** Rrënimi i imazhit të kundërshtarit dhe nxitja e mosbesimit ndaj tyre në qarqe politike me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare përbën një rëndësi nga shtyllat e rëndësishme të strategjisë në luftën politike. Në funksion të kësaj strategjie në të gjitha periudhat vendimtare historike që lidhen me fatet e popujve në Ballkanin Perëndimor, armiqhtë

tanë përdorën atributet më negative të kohës për t'i cilësuar shqiptarët. Kështu për shembull: Në periudhën e krijimit të shteteve kombëtare në Ballkan, shqiptarët stigmatizoheshin nga serbët dhe nga grekët si "mbeturina të Perandorisë Otomane, që dëshironin ta ruanin praninë e Turqisë në Europë"; Gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas përfundimit të saj, shqiptarët cilësoheshin si "shërbëtorë të nazi-fashistëve"; Në kohën kur Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ) kishte marrëdhënie të mira me Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike (BRSS), shqiptarët përndiqeshin si "antikomunistë"; Pas prishjes së

marrëdhënieve me BRSS (1948), shqiptarët përndiqeshin si "stalinistë"; Pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981, shqiptarët u akuzuan si "nacionalistë", "irredentistë", "separatistë"; Përmbysja e regjimeve komuniste në kontinentin evropian dhe shpartallimi i Bllokut Socialist nxori në shesh krimet monstruoze që ishin bërë gjatë sundimit të tyre. Duke qenë në të gjitha strukturat e pushtetit dhe duke pasur monopol edhe në mediet e kontrolluara prej tyre, komunistët e shfrytëzuan kontekstin e ri për t'i hequr "uniformat e satrapit" dhe për ta veshur "kostumin e demokratit". "Konvertimi" i tyre "në demokratë" nuk u kufizua

vetëm në "braktisjen" e doktrinës komuniste, por u lëshuan në një ofensivë mediatike të tërbuar për t'i stigmatizuar si "marksist-leninistë-stalinistë-enveristë" të gjithë "nacionalistët", "separatistët" dhe "irredentistët" e dikurshëm që synonin t'ua prishnin vëllazërim-bashkimin komunist! Gjatë kohës së shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë, "terrorizmi me motive fetare" ishte kualifikimi më negativ në kontekstin politik ndërkombëtar. Për këtë arsye, përpjekja për ta prezantuar UÇK-në si "organizatë terroriste me pikëpamje fundamentaliste islamike" përbënte një rëndësi nga shtyllat kryesore të orientimit propagandues të Shtabit Strategjik të regjimit të Slllobodan Millosheviqit. Dhe sado e pabesueshme t'i duket dikujt që një grup i caktuar të stigmatizohet në të njëjtën kohë si organizatë e orientimit "fundamentalist islamik" dhe si "e majtë ekstreme e tipit stalinist të Enver Hoxhës", pra ekstremist fetar dhe ithtar i ideologjisë që kishte ndaluar besimin fetar në Shqipëri, më shumë se gjysma e "Librit të bardhë", botimi i vitit 1998, është propagandë që

synonte të krijonte opinionin e vendeve demokratike perëndimore se gjoja UÇK-ja ishte organizatë "marksist-leninistë-stalinistë-enveristë-fundamentaliste islamike"!

**"Epoka e re":** Në vijim do të bisedojmë edhe rreth termeve të tjera që u përdorën në luftë për të krijuar dyshime rreth orientimeve politike dhe ideologjike të UÇK-së, mirëpo tani po ndalemi në termin "marksist-leninist", i cili është përdorur edhe nga organizata të fshehta në Kosovë. Në çfarë kuptimi mund të përdoret kjo doktrinë në kuadër të një lëvizjeje çlirimtare kombëtare?

**Bardhyl Mahmuti:** Në dallim nga sistemet politike demokratike ku forca të orientimeve të ndryshme politike dhe ideologjike konkurrojnë hapas për pushtet, në vendet ku pushteti është në duar të një partie politike dhe ku me ligj ndalohej çfarëdo forme e organizimit tjetër politik, kundërshtarëve të këtij pushteti u mbetet vetëm mundësia e organizimit fshehtas. Për kontekste të tilla politike Marksist dhe sidomos Lenini kanë vënë parimet dhe modalitetet mbi



bazën e të cilave mund të organizohet rezistenca e fshehtë. Pikërisht mbi bazën e parimeve të organizimit “në treshe” funksiononin të gjitha grupet dhe organizatat atdhetare në viset shqiptare nën Jugosllavi.

Parimet marksiste-leniniste të organizimit aspak nuk kanë të bëjnë me ideologjinë e Marksit dhe Leninit, por kufizohen vetëm në formën e organizimit të fshehtë në regjimet absolutiste dhe totalitare. Pa marrë parasysh orientimin ideologjik, këto parime të organizimit mund t’u hyjnë në punë organizatave që shkojnë nga “e majta ekstreme” e deri tek “e djathta ekstreme”.

Për ta bërë më të qartë për lexuesin se parimet marksiste-leniniste të organizimit nuk kanë asgjë të përbashkët me ideologjinë marksiste-leniniste po marr një shembull të shfrytëzimit të këtyre parimeve organizative nga një organizatë me pikëpamje ideologjike diametralisht të kundërta me pikëpamjet marksiste-leniniste! Në fund të viteve ’60 dhe në fillim të viteve ’70, juristi boshnjak Alia Izetbegović, i cili gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë ishte president i Bosnjë-Hercegovinës, hartoi platformën politike të titulluar “Islamska deklaracija” (Deklarata islame). Në këtë material z. Izetbegović shtroi parimet e funksionimit të shtetit mbi bazën e islamit sunit, ku pushteti do të ishte në duar të teokratëve që do ta zbatonin

sheriatin. Në pamundësi të organizimit publik të një force politike që do të mbështeste këtë platformë, organizimi u bë fshehtas në përputhje mbi parimet e marksiste-leniniste të funksionimit “në treshe”. Në të ashtuquajturin “Proces i Sarajevës”, anëtarët e grupit të Alija Izetbegovićit u dënuan si “fondamentalistë islamikë” e jo si “të majtë” që kanë përdorur formën “marksiste-leniniste” të organizimit, sepse komunistët jugosllavë e ruanin për vete atributin “të majtë”.

Nëse u hedhim një sy aktakuzave dhe aktgjyqimeve të qindra grupeve dhe organizatave patriotike shqiptare në Jugosllavinë Socialiste, do të bindemi se në asnjë rast të vetëm dhe askush nuk është dënuar si “marksist-leninist” por, e përsëris, si “nacionalist”, “irredentist” dhe “separatist”. Megjithatë nuk mund të përjashtohet mundësia që në mesin tonë ka pasur edhe ithtarë të kësaj doktrine politike. Mirëpo Lëvizja Popullore e Kosovës ka këmbëngulur në unitetin e kombit shqiptar dhe lënien anash të dallimeve brenda shqiptare. Për LPK-në çlirimi i vendit ka qenë parakusht për krijimin e rrethanave ku çdonjëri do të kishte mundësi të përcaktohej politikisht dhe ideologjikisht për atë forcë politike që i pëlqen. Dhe ashtu ndodhi. Pas përfundimit të luftës, një pjesë e anëtarëve të LPK-së krijuan PDK-në (të orientimit politik

“qendër”), një pjesë u angazhua në AAK (“e djathtë”), një pjesë krijoi Partinë Socialiste (“e majtë”), ndërsa disa vazhduan ta ruajnë LPK-në si lëvizje atdhetare jashtë përcaktimeve ideologjike.

**“Epoka e re”:** *Megjithatë propaganda serbe që ju stigmatizonte me epitete të “izmave” të ndryshme nuk mbeti pa efekte as në rrafshin e brendshëm, as në atë ndërkombëtar.*

**Bardhyl Mahmuti:** Nëse flasim për hapësirën shqiptare, në vend që të turpëroheshin për shërbimet që u kishin bërë okupatorëve dhe të kërkonin falje publike për veprimet e tyre antishqiptare në kuadër të pushtetit komunist jugosllavë, ata u lëshuan në një fushatë të tërbuar kundër nesh. Sidomos ata anëtarë të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, të përkatësisë etnike shqiptare, të cilët vazhduan të marrin udhëzime nga Beogradi. Madje edhe sot e kësaj dite, një çerek shekulli nga përfundimi i luftës, pjella e komunistëve jugosllavë vazhdon t’i stigmatizojë luftëtarët e lirisë me epitete të ndryshme! Fatkeqësisht argatët shqiptarë të komunistëve jugosllavë kanë pasur një ndikim tepër negativ edhe në skenën politike ndërkombëtare, sepse epitete që na ngjiteshin nga propaganda serbe përforcoheshin nga goja e shërbëtorëve “shqiptarë” të okupatorit dhe ua shtonin besueshmërinë.

**“Epoka e re”:** *A ka pasur masa konkrete kundër jush nga shtetet e demokracive perëndimore që mund të konsiderohen si rezultat i propagandës së tillë?*

**Bardhyl Mahmuti:** Po. Përkundër asaj se LPK-ja asnjëherë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim që do të mund të hynte në kategorinë e akteve ekstreme, në disa raporte vjetore të Zyrës Federative për mbrojtje të Kushtetutës në Gjermani (Bundesamt für Verfassungsschutz), që ka për mision, ndër të tjera, edhe identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që i kanosen këtij shteti nga grupet politike ekstremiste dhe nga terrorizmi, figuron edhe LPK-ja. Madje gjatë momenteve vendimtare të luftës sonë çlirimtare, njëri nga themeluesit dhe udhëheqësit e LPK-së, Ibrahim Kelmendi është dashur të lajmërohet çdo javë që të diskutojë me zyrtarë të këtij institucioni lidhur me aktivitetet tona për të vlerësuar nëse kemi kaluar “vijat e kuqe” që kishin përcaktuar ndaj nesh. Ndërkaq, në muajin korrik të vitit 1998, u bastisën zyrat e fondit “Vendlindja thërret” dhe banesat e veprimtarëve Agush Buja, Shaban Muja dhe Mehmet Bislimi, i cili në momentet e bastisjes së banesës së tij nuk ishte në Zvicër. Po atë ditë, në Selinë e Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, grupi diplomatik i UÇK-së organizoi konferencë me gazetarët e akredituar në këtë institucion ndërkombëtar

dhe paralajmëroi protesta masive në të gjitha qytetet kryesore të Zvicrës. Fatmirësisht Agush Buja dhe Shaban Muja u liruan dy orë pas përfundimit të konferencës sonë dhe nuk pati nevojë të bëjmë asnjë demonstratë proteste. Mirëpo kontoja e fondi “Vendlindja thërret” u bllokua nga autoritetet zvicerane dhe u detyruam të hapnim konte të re në një bankë alternative. Pas një kohe të shkurtër edhe ajo konto u bllokua...

**“Epoka e re”:** *Domethënë keni pasur edhe presione të drejtpërdrejta?*

**Bardhyl Mahmuti:** Po ju përmend edhe një rast që flet shumë për këto forma presionesh që bëheshin ndaj nesh. Në kohën kur delegacioni i Kosovës kërkonte përfshirjen e referendumit në marrëveshjen si instrument për vendosjen e statutit politik përfundimtar të Kosovës, Gjermania e bllokoi xhirollogarinë e fondit “Vendlindja thërret” në këtë shtet. Pas disa ditësh, zyrtari gjerman i institucionit të lartpërmendur kontaktoi me Ibrahim Kelmendin dhe kërkoi të dinte nëse vendimi i bllokimit të xhirollogarisë kishte ndikuar te delegacioni i UÇK-së. Mirëpo ai ishte shtangur kur kishte marrë vesh nga Ibrahim Kelmendi se për vendimin e tillë as që i kishim informuar delegacionin e UÇK-së, për ta kursyer nga presioni.

(Muhamet Mavraj / Vijon)





# Dhomat e Specializuara, një karikaturë dhunimi!

Shkruan: Sali BISLIMI, drejtor i zyrës ligjore First-consulting.ch dhe Zërit Perëndimor të Kosovës

Dhomat e Specializuara të Kosovës, përgjegjëse për gjykimin e ish-çlirimtarëve të vendit, u krijuan me nxitim dhe me detyrim nga Qeveria e Kosovës. Si mund ta imagjinojmë në fakt legjitimitetin e një drejtësie të "shpërngulur" në Hagë, duke ditur se ajo u krijua pas raportit të Dick Marty-t që bënte akuza serioze për të ashtuquajturin trafik organesh, i cili nuk është vërtetuar.

Rendi juridik ndërkombëtar sigurisht që ka pasur mundësinë të krijojë këtë lloj tribunali special, veçanërisht gjatë gjyqeve të Nurembergut në fund të Luftës së Dytë Botërore. Megjithatë,



ndryshe nga Dhomat e Specializuara, gjykata ndërkombëtare e Nurembergut e mori legjitimitetin e saj nga vullneti i shteteve ndërluftuese që fituan luftën, për të ndjekur abuzimet e kryera nga ish-zyrtarët nazistë fajtorë në veçanti

për gjenocidet. Ajo u përgjigj imperativave të drejtësisë dhe dëmshpërblimit moral në lidhje me popujt e sakrifikuar duke ndjekur penalisht torturuesit e tyre të kohës.

Qëllimi i Dhomave të Specializuara është krejt tjetër dhe

i kundërt, pasi ata administrojnë drejtësi penale kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së, përfshirë edhe presidentin Thaçi, pasi kanë punuar për pavarësinë e një vendi kundër okupatorit serb dhe kanë mbjell substancën e një shteti demokratik të njohur nga shumica dërrmuese e bashkësisë ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, a është e drejtë dhe politikisht e mbrojtshme që një institucion gjyqësor i lindur nën presionin e disa shteteve të gjykojë njerëz që mishërojnë vetë ekzistencën e shtetit të tyre? Pra, gjykimi i presidentin Thaçi është të vihet në pikëpyetje legjitimiteti politik dhe ekzistencial i vetë Kosovës, si shtet juridik i njohur ndërkombëtarisht.

Kur Marshall Pétain, ish-president i Këshillit Francez nën pushtimin gjerman të viteve 1939-1945, u dënua me vdekje për tradhti të lartë me armikun, më pas u ndryshua në burgim të

përjetshëm, gjykimi i tij iu bind një logjike drejtësie të brendshme dhe jo të jashtme. Pétain u dënua nga kolegët e tij, Gjykata e Lartë e Drejtësisë, në Francë dhe jo nga një juridiksion artificial dhe i huaj. Për më tepër, drejtësia e dhënë në Hagë ka të bëjë vetëm me ish-çlirimtarët kosovarë, me përjashtim të liderëve politikë serbë, është krejtësisht arbitrare, sepse bën të paqëndrueshme nga pikëpamja e trajtimit të barabartë. "Vaevictis" ose mjerë për të mundurit shpreh shprehjen latine, humbësit e një lufte janë gjithmonë në mëshirën e fitimtarëve. Në rastin konkret, më mirë do të ishte "mjerë fitimtarët", në përpjesëtim me ecurinë e gjyqeve të ish-çlirimtarëve të një populli që nuk e kupton këtë parodi të drejtësisë ndërkombëtare.

Hero të vendit tim festa e 28 Nëntorit pa ju është e zbehtë. Liri Çlirimtarëve!

## Udhëtimi pa viza nga 1 janari, për një ditë një person duhet të ofrojë dëshmi financiare rreth 100 euro

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Faqja qeveritare Integrimi Evropian i Kosovës ka ndarë disa informata për shumën e parave që duhet të kenë me vete qytetarët e Kosovës që do të udhëtojnë për në zonën Shengen pas 1 janarit 2024. Sipas kësaj faqe, si udhëtar me të arritur në pikën e parë kufitare të Shengenit, nga policia kufitare juve mund t'ju kërkohet nëse keni dëshmi të mjaftueshme financiare për udhëtimin tuaj. Sasia e këtyre mjeteve varet nga dy grupe faktorësh: 1) nga numri i ditëve që do të qëndroni dhe shteti të cilin e vizitoni dhe 2) nga ajo nëse do të qëndroni në

akomodim me pagesë si hotel/apartament apo tek të afërmit tuaj.

"Nëse deklaroni se do të qëndroni tek të afërmit tuaj duke ofruar adresën dhe kontaktin e tyre, varësisht se cilin shtet e vizitoni, shumën e mjeteve është rreth 30 - 50 euro në ditë për person. Nëse deklaroni se do të qëndroni në një hotel apo apartament apo çfarëdo akomodimi tjetër me pagesë, varësisht se cilin shtet e vizitoni, shumën e mjeteve që duhet të ofroni si dëshmi financiare është rreth 50 - 100 euro në ditë për person", thuhet në njoftimin e faqes Integrimi



Evropian i Kosovës.

Më tutje në njoftim thuhet se akomodimi nga miqtë apo familjarët mund të verifikohet duke kontaktuar drejtpërdrejt

mikpritësin me telefon ose duke verifikuar adresën e tyre përmes policisë.

Derisa verifikimi i mjeteve të mjaftueshme financiare mund të

bëhet në disa forma duke ju kërkuar të tregoni para të gatshme (cash), kartelë bankare, kartë krediti, letër konfirmimi nga një konferencë apo seminar që mbulon shpenzimet tuaja për akomodim e ushqim, dëshmi për pagesën e hotelit apo çfarëdo konfirmimi a dëshmie tjetër për kostot tuaja gjatë udhëtimit.

Gjithashtu, ju nuk keni nevojë të keni të deponuara sasi të caktuar të mjeteve në bankë, por ju duhet të dëshmoni që keni mjete të mjaftueshme financiare për ta mbuluar qëndrimin tuaj atje duke përfshirë kostot për kthimin në Kosovë.

## Siguria ushqimore, punësimi i lirë i veterinerëve: Nënshkruhet marrëveshja Kosovë - Shqipëri - Maqedoni e Veriut



PRISHTINË, 28 NËNTOR - Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë nënshkruar marrëveshjen mbi sigurinë ushqimore dhe punësimin e lirë të veterinerëve. Lajmi është bërë me dije nga Oda e Veterinerëve e Kosovës, sipas së cilës, marrëveshja u nënshkrua në kuadër të shtimit të marrëdhënieve midis dhomave dhe forcimit rajonal kundrejt

kërkesave dhe standardeve të tregut dhe Bashkimit Evropian. "Siguria ushqimore në lëvizjen e lirë të kafshëve në vendet kufitare për t'i eliminuar sëmundjet e transmetueshme, por nga ana tjetër tregu i lirë i punës për mjekët veterinerë në vendet ndërkufitare, ka qenë qëllimi i takimit midis dhomave të veterinarisë", thuhet në njoftim.

Marrëveshja e arritur ndërmjet tri vendeve synon ngritjen e standardeve të mjekëve veterinerë, trajnimin të vazhduar dhe tregut të lirë të punës midis shteteve për të mirën e konsumatorëve. Ndryshe, me Maqedoninë e Veriut kjo marrëveshje rinovohet, ndërsa me Kosovën u nënshkrua për herë të parë, përfundon njoftimi.

## Borrelli thotë se do të vazhdojnë të sigurojnë stabilitet në veri të Kosovës

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, pas takimit me ministrat e jashtëm të NATO-s të martën në Bruksel, ka deklaruar se anëtarët e Bashkimit Evropian janë të angazhuar për paqe në Ballkanin Perëndimor. Ai në një videoadresim në rrjetin social "X" ka thënë se KFOR-i dhe EULEX-it do ta vazhdojnë bashkëpunimin me qëllim të

sigurimit të stabilitetit në veri të Kosovës.

"Në këtë sesion ne folëm për Ballkanin Perëndimor. Ju e dini se sa i rëndësishëm është Ballkani Perëndimor për BE-në. Shumë anëtarë të bllokut janë të angazhuar për stabilitet në këtë rajon dhe shumë shtete të këtij rajoni janë candidate. Stabiliteti i tyre, prosperiteti dhe përshtatja me politikën e

jashtme është shumë e rëndësishme për ne. Më lejoni ta theksoj rëndësinë e bashkëpunimit mes BE-së dhe NATO-s në veri të Kosovës". Ai ka theksuar se EULEX-i ndër vite ka luajtur rol të rëndësishëm për paqen në Kosovë dhe se do të vazhdojë ta bëjë një gjë të tillë edhe në të ardhmen.

Borrelli u ka bërë thirrje Kosovës

dhe Serbisë ta rritin vullnetin për marrëveshje për rrugën e tyre evropiane. "Misioni ynë i EULEX-it është i pozicionuar dhe ka një bashkëpunim të fortë me KFOR-in dhe po përballen me momente të vështira. Ne do të vazhdojmë të sigurojmë stabilitet dhe siguri në këtë pjesë të Kosovës dhe në kufirin me Serbinë", ka thënë Borrelli.





# “Javët e Biznesit Kosovar 2023”, thirrje për konsumim të produkteve vendore

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), e mbështetur edhe nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përkatësisht nga Agjencia KIESA, në frymë festive, në prag të festës së flamurit kombëtar shqiptar - 28 Nëntorit, ka shënuar “Javët e Biznesit Kosovar 2023”, me moton e veçantë “Blej produkte vendore”.

Kjo ngjarje ka për qëllim kryesor ta vlerësojë dhe përforcojë krijimtarinë vendore me produkte me vlerë përmes mbështetjes me politika dhe instrumente të ndryshme qeveritare, krijimit të lidhjeve në mes të bizneseve me diskutime në vijim në mes të përfaqësuesve qeveritarë dhe komunitetit të biznesit për instrumentet dhe skemat mbështetëse për prodhuesit vendorë, për ta shpalosur potencialin e tyre në industrinë prodhuese, me rol kryesor për zhvillim ekonomik, social dhe mjedisor në vendin tonë.

Në kuadër të këtij aktiviteti u ekspozuan produktet e mbi 50 bizneseve prodhuese të industrisë vendore dhe të afër 40 grave ndërmarrëse si anëtare të shoqatave artizanale dhe bujqësore.

Në fjalën e saj para të pranishmëve, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe



Tregtisë, Rozeta Hajdari, tha se Kosova ka një pasuri të pashtershme të resurseve natyrore e njerëzore, të cilat, përmes zbatimit të Politikës Industriale 2030, me shfrytëzim efektiv të potencialit të industrisë prodhuese, do të sjellin produkte me vlerë të lartë të shtuar në tregun vendor e ndërkombëtar dhe zhvillim e transformim më të shpejtë ekonomik në vendin tonë.

Duke e theksuar moton e

ngjarjes “Blej produkte vendore” me ftesë që tryezat tona familjare, në çdo ditë të vitit të jenë me produkte vendore cilësore dhe të sigurta, ajo tha se kështu e forcojmë ekonominë dhe shtetin tonë. Ajo shtoi se një ngjarje e tillë shërben si mundësi për ta përkrahur dhe festuar talentin e pasionin e ndërmarrësve tanë, të cilët në vazhdimësi po sjellin në pah inovacionin dhe cilësinë e produkteve dhe shërbimeve për

tregun vendor dhe ndërkombëtar.

Konferenca u përmyll me një panel diskutimi me temë “Zhvillimi dhe promovimi i prodhimeve vendore”, ku u prezantuan instrumentet dhe skemat mbështetëse për ndërmarrësit vendorë, për avancim të teknologjisë, standardizim dhe certifikim, digjitalizim dhe trajnim për menaxhim të biznesit, me qëllim rritjen e prodhimit

vendor industrial dhe rritjen e eksporteve për përmirësim të bilancit tregtar, me ç’rast të pranishmit patën mundësi të parashtronjë pyetje të shumta për panelistët.

Aktivitetet në kuadër të Javëve të Biznesit do të vazhdojnë me konferenca, promovime, tryeza dhe forume me tema të ndryshme për zhvillim dhe promovim të mëtejshëm të prodhimit vendor industrial dhe rritje të eksportit.

## Kosova nuk po bën mjaftueshëm për ta zvogëluar varësinë nga thëngjilli

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Kosova, si dhe dy vendet e tjera të Ballkanit, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina, nuk po bëjnë mjaftueshëm për ta zvogëluar varësinë nga thëngjilli dhe për ta ulur emetimin e gazrave serrë në atmosferë, sipas një raportit të Rrjetit për Veprim Klimatik (RRVK).

Raporti i koalicionit joqeveritar evropian, i cili i lufton ndryshimet klimatike, thekson se Kosova, Serbia dhe Bosnja nuk i kanë përmbushur synimet e caktuara në Planet Klimatike dhe Energjinë Kombëtare (PKEK), si dhe kanë bërë përpjekje të vogla për të krijuar strategji konkrete për ta hequr thëngjillin nga përdorimi.



“Varësia e vazhdueshme në thëngjill të vjetruar dhe joefikas e pengon tranzicionin e shumënevojshëm në burime të

energjisë së ripërtëritshme në rajon. Kjo e minon fizibilitetin e zbatimit të politikave çmimore të karbonit, të cilat nuk adresohen

siç duhet në PKEK”, thuhet në raport.

Në Kosovë, PKEK-u nuk ofron një strategji gjithëpërfshirëse për heqjen nga përdorimi të linjtit, një thëngjill i butë që Kosova ka shumë, ndërsa pritjet janë që termocentralet të mbeten në punë përtej vitit 2040, thuhet në raport.

“Kjo mungesë e strategjisë nënvizon një mungesë të madhe të përkushtimit të Kosovës për dekarbonizim”, sipas raportit. Bosnja, vendi i vetëm i rajonit që eksporton rrymë, prodhon 60 për qind të rrymës përmes termocentraleve me thëngjill dhe pjesën tjetër përmes hidrocentraleve.

Kosova dhe Serbia prodhojnë 90 për qind dhe 70 për qind, përkatësisht të rrymës përmes termocentraleve me thëngjill, ndërsa pjesën tjetër përmes hidrocentraleve dhe centraleve solare dhe të erës.

Raporti theksoi s, derisa Kosova dhe dy vendet e tjera të Ballkanit kishin theksuar në planet e tyre synime të përgjithshme për të kaluar në energji të gjelbër, duke u zotuar për ndaljen e investimeve në prodhimin e rrymës përmes thëngjillit, ato dështuan të ofronin të dhëna të hollësishe për shkallën e kapacitetit dhe strategjitë e futjes së energjisë së ripërtëritshme në rrjet.

### Rritet çmimi i naftës

Prishtinë, 28 nëntor - Çmimet e naftës u rritën të martën për shkak të pasigurisë së furnizimit, pasiguri kjo e cila u rrit për shkak të mosmarrëveshjeve midis anëtarëve të OPEC + (Organizata e Vendeve Eksportuese të Naftës) mbi kuotat e tyre të prodhimit për vitin e ardhshëm.

Nafta e papërpunuar standarde ndërkombëtare

Brent tregtohej me 80,50 dollarë për fuçi në orën 11:40 të mëngjesit me orën lokale, një rritje prej 0,79 për qind nga çmimi i mbylljes prej 79,87 dollarë për fuçi në seancën e mëparshme tregtare të hënën. Standardi amerikan West Texas Intermediate (WTI) tregtohej në të njëjtën kohë me 75,47 dollarë për fuçi, 0,81 për qind më shumë nga mbyllja e së hënës prej 74,86

dollarë për fuçi.

Pasiguritë e furnizimit në tregjet globale të naftës vazhdojnë të ndikojnë në çmimet e naftës. Takimi i anëtarëve të OPEC+ i planifikuar për 26 nëntor në Vjenë u shty për 30 nëntor, shkruan AA.

Grupi pritet t'i përcaktojë kuotat e prodhimit që do të vendosen nga janari e në vazhdim.





# Dosja osmane për jetën e Ismail Qemalit dhe disa reflektime të gazetave osmane ndaj pavarësisë së Shqipërisë

Nga: Agron ISLAMI

Pa dyshim që Ismail Qemali i takon plejadës së artë të intelektualëve të shekullit më të gjatë osman. U rrit në familjen e madhe shqiptare, e cila për shekuj me radhë kishte qenë pjesë e udhëheqjes brenda Perandorisë Osmane, duke i dhënë shumë funksionar shtetëror kësaj perandorie. Ishte njëri nga pinjollët e familjes së Vlorajve, siç njihet edhe në dokumentacionin zyrtarë osman (Avlon-ja), që personalitetin e tij e formoi në frymën dhe traditën e familjeve shqiptare.

Historiku i shkollimit të tij, nuk ndryshon aspak nga paraardhësit e tij të familjes, por që rrethanat politike në Perandorinë Osmane të shekullit kur jetoi dhe veprimi Ismail Qemali, bën që ky i fundit të dallohet edhe për patriotizëm (në një kohë kur vlonte nacionalizmi), gjë të cilën e realizonte nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në politikën osmane. Ai, si baba i shtetit shqiptarë, ishte dhe mbetet njëri nga burrat më të shquar të kombit shqiptar.

\*\*\*

Si çdo funksionar osman, edhe Ismail Qemal Beu kishte dorëzuar dosjen e jetëshkrimit të tij në administratën osmane, e cila duhet jetë deponuar në kohën kur ai filloi karrierën e tij si nëpunës osman në zyrën e përkthimit në Ministrinë e Jashtme osmane.

Sipas kësaj dosje të regjistrimit civil osman, Ismail Qemali lindi më 04 shkurt 1847. Ishte i biri i kryeportierit të Sarajit Osman, Mahmud Nedim Beut, i cili vinte nga soji i Sinan Pashës. Mësimet fillestare të shkencave islame i kishte marrë në mejtepet (shkolla) fillore në Selanik dhe në Vlorë. Njëherësh, gjatë kësaj periudhe mësoi edhe gjuhën arabe dhe perse nga një mësues privat, të cilin e kishte angazhuar familja. Formimin e tij intelektual e vazhdoi në gjimnazin "Zosimea", ku mori mësim mbi morfologjinë dhe sintaksën e greqishtes së vjetër, latinishtes dhe frëngjishtes. Në kuadër të skemës programore të gjimnazit në fjalë, Ismail Qemali kishte ndjekur edhe lëndët: letërsi, aritmetikë, algjebër, gjeometri, trigonometri, fizikë, kimi, astronomi, psikologji, anatomi e njeriut, gjeografi dhe histori e botës. Regjistri osman vë në pah se Ismail Qemali shkruante gjuhën turke, greke dhe frënge, fliste gjuhën shqipe dhe lexonte latinishten. Sipas këtyre të dhënave, ai ka edhe një vepër të botuar me titull Aplikimi i ideve, i cili trajton çështje të filozofisë dhe shkencës.

## Karriera burokratike në administratën osmane

Sa u përket të dhënave për kontributin e Ismail Qemalit në administratën osmane, shohim se, ai qysh në moshën 16 vjeçare,

respektivisht nga muaji maj i vitit 1860, u caktua nëpunës në Zyrën e Përkthimit të Portës së Lartë Osmane. Një vit më pas, (mars 1861), u emërua atashe i Ambasadës Osmane në Paris, por për shkaqe të panjohura (në regjistrin osman thuhet, për arsye personale) nuk u paraqit në detyrën e përcaktuar. Një vit më vonë, (gusht 1862), u emërua në Sekretariatit e Korrespondencës me Jashtë, pranë Vilajetit të Janinës. Ndërsa pas 18 muajve, iu besua posti i kryetarit të bashkisë të sapoformuar të Janinës. Rreth një viti më vonë (shtator 1864), kontributin e tij e vazhdoi në cilësinë e asistentit të guvernatorit të Tërhallës, Ismail Rahmi Pashës nga Tepelena. Më 1865 rikthehet në Stamboll, ku punon në zyrën e Përkthimit të Portës së Lartë. Pas një viti (maj 1866), emërohet sekretar i Byrosë së Korrespondencës së Vilajetit të Danubit me rrogë prej 2 500 groshë. Nga cilësia e sekretarit të Byrosë, për dy muaj me radhë mbuloi edhe detyrën e kolumnistit në gazetën zyrtare të Vilajetit, e po ashtu si punë shtesë iu besua edhe posti i drejtorit të Punëve të Jashtme në Vilajetin në fjalë. Njëherësh, nga muaji mars i vitit 1868, u caktua edhe në postin e kryesekretarit të Kuvendit Administrativ të Vilajetit të Tërhallës.

Nga detyrat e shumta në Vilajetin e Tërhallës, Ismail Qemali në qershor 1868 ushtroi detyrën e kryendihmësit të Zyrës Juridike të Këshillit Shtetëror, me një rrogë prej 4 000 groshë. Pas 16 muajve (tetor 1869), do të ngrihet në postin e mytesarifit të Varnës në Bullgari, me një rrogë prej 12 200 groshësh. Ndërsa në muajin shkurt 1870, iu bashkua Kryesisë së Komisionit Evropian të Danubit dhe u emërua Mytesarëf i Tullxhës në Rumani, me rrogë prej 14 000 groshë. Në këtë pozitë qëndroi plot tre vjet.

Sixhili osman nuk jep informacion mbi aktivitetin e Ismail Qemalit gjatë periudhës 1873-1876, respektivisht deri në muajin gusht të vitit 1876, kur emërohet në Sekretarinë e Ministrisë së Jashtme. Megjithatë, është i njohur fakti se që nga viti 1873, së bashku me konsullin anglez, Mr. Meyers, kishin në pronësi një minierë linjiti. Ndërsa, në vitin 1875, për dy muaj qëndroi në Angli ku zhvilloi takime me ministrin e Jashtëm dhe atë të Financave, si dhe pa nga afër politikën fiskale dhe qeverisjen lokale britanike. Këto kontakte erdhën si rezultat i raporteve të gjata që kishte mbajtur me përfaqësuesit e parlamentit britanik, ku përmes letërkëmbimeve me Mr. York, Wydham dhe Bruce, shkëmbeu ide për gjendjen në Ballkan. Ndërsa nga muaji shtator i vitit 1876, emërohet anëtar i Komisionit të Jashtëzakonshëm të Plovdivit në Bullgari dhe kryetar i Komisionit të Jashtëzakonshëm në Slivenit të Bullgarisë, po ashtu.

Etapa 1877-1912 karakterizohet me vitet e disidencës së Ismail Qemalit karshi sistemit klasik osman. Respektivisht, Ismail Qemali do të qëndrojë krah për krah me Mithat



Pashën i cili njihet për qëndrime reformiste të Perandorisë Osmane. Në kuadër të kësaj qasjeje, nga pozita e sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme organizonte takime me Mithat Pashën, sidomos gjatë muajve kur Sulltan Murati V ishte i sëmurë dhe nuk ishte në gjendje të drejtonte shtetin.

Me shpalljen e konstitucionit më 1876, Mithat Pasha erdhi në pozitën e sadriazamit (kryeministrit) dhe Ismail Qemali ruajti pozitën e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Ai u qëndronte besnik ideve të Mithat Pashës, të cilat parashihnin reformë të thellë nëpër njësitë administrative osmane dhe ku parashihej që Vilajetet e banuara me shqiptarë të bashkoheshin në një njësi administrative të vetme, të quajtura Vilajeti Shqiptar. Besnikërinë ndaj Mithat Pashës do ta shprehte edhe në organizimin e mbledhjes së nënshkrimeve nga 40 deputetë të parlamentit osman që kërkonin zhbërjen e vendimit të Abdylhamitit II për syrgjynosjen e Mithat Pashës.

Depërtimi i ushtrive ruse deri në Ardahan krijoi një realitet të ri në qendrën e Perandorisë Osmane, i cili u përçoll me protesta të grupacioneve që dhunuan edhe hapësirat e Parlamentit osman. Si pretekst i kësaj gjendjeje, Sulltani mbylli Parlamentin, shpalli gjendjen e jashtëzakonshme dhe syrgjynosi Ismail Qemal Beun në Kytahja. Në vitin 1884, Sulltani shpalli amnistinë për Mithat Pashën dhe Ismail Qemalin po ashtu. Këtij të fundit ia riktheu të gjitha gradat dhe e ngarkoi me detyrën e mytesarifit në Mardin dhe Bollu (të Turqisë së sotme).

Bashkëpunimi i Ismail Qemal Beut me Portën e Lartë dhe Sulltan Abdylhamitin II shihet edhe në raportet që ky hartonte me tematikë gjendjen politike dhe administrative të perandorisë. Këto raporte i bënte herë me kërkesën e Sulltanit e herë me iniciativë personale. Njëherësh është i njohur fakti se, me lejen e Sulltanit, Ismail Qemali, kishte qenë njëri nga aksionarët e dy kompanive që kryenin punimet e hekurudhës

osmane. Nga këtu, më 14 dhjetor 1891 emërohet vali (guvernator) në Bejrut (Liban) me një rrogë prej 20 000 groshëve. Ismail Qemali nga data 12 prill 1900 deri me 20 qershor 1900 kishte qenë në detyrën e valiut (guvernatorit) të Tripolit.

## Bashkëpunimi me xhonturqit dhe shpallja e pavarësisë së Shqipërisë sipas medias osmane të kohës

Edhe pse studiuesit e ndryshëm kanë konstatuar se emërimi i Ismail Qemalit në postin e guvernatorit në Tripoli u bë shkak që ky të rreshtohet me krahun e xhonturqve, ngase këtë emërim e konsideronte si një lloje syrgjynosjeje që i ishte bërë nga ana e Sulltanit, aktiviteti i tij politik dhe simpatia e madhe që ndjente ndaj Mithat Pashës na çon te shpirti i tij reformist dhe interesi kombëtar. Njëherësh, një personalitet me karrierë të gjatë politike në ujërat e shekullit më të gjatë osman, siç ishte Ismail Qemali, veçse e kishte shumë të qartë faktin që Perandorisë Osmane po i vinte fundi dhe ishte mundësia e fundit, po ashtu, që të ruhej identiteti shqiptar dhe kjo mund të bëhej vetëm nëpërmjet rrugëve juridike, respektivisht krijimit të një njësie të veçantë administrative që do të përfshinte gjithë hapësirën shqiptare. Mbi këtë bazë, doli kundër Sulltanit dhe u rreshtua me xhonturqit. Meqë, këta të fundit, me qëllim të tërheqjes së intelektualëve shqiptarë, në fillim kishin proklamuar reformën administrative dhe shihej një dritë në fund të tunelit për themelimin e Vilajetit Shqiptar. Por, siç do të shihet më vonë, politikën qeverisëse të xhonturqve ishin kryekëput nacionaliste dhe si të tilla ato dëmtonin edhe më shumë idealin e Ismail Qemalit dhe të intelektualëve të tjerë shqiptarë. Për rezultat, Ismail Qemali, i ndau rrugët njëherë e përgjithmonë nga Porta e Lartë dhe filloi së kërkuari ndihmën e shteteve të fuqishme evropiane për themelimin e shtetit shqiptar.

Duke qenë se Vilajetet Shqiptare luanin rolin e fortifikatës së fundit në Rumelinë Osmane (Ballkanin e Sotëm), çështja e fatit të Shqipërisë dhe shqiptarëve zënë një vend të rëndësishëm në gazetën osmane të kohës. Sikur vije fjala në njërin ndër gazetën më të njohura osmane Tercuman-i hakikat, e cila ndër tjera theksonte se: Kërkesa për pavarësimin e Shqipërisë është e rrezikshme për vetë popullin. Meqë, Shqipëria është e rrethuar me popuj të ndryshëm, të cilët ushqejnë armiqësi ndaj shqiptarëve dhe ndarja nga shteti osman do t'i shkatërronte ata.

Ndërsa, gazeta Ikdam, në numrin e datës 2 dhjetor 1912, ndër të tjera i jepte hapësirë një interviste të një intelektualit shqiptar. Në intervistën në fjalë, ndër të tjera thuhet: Çështja e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë është më se e vërtetë dhe është (një) risi. Përveç Ismail Qemalit, edhe intelektualët e tjerë shqiptarë e kanë mbështetur dhe përkrahur pavarësinë e Shqipërisë. Madje, kjo ka marrë mbështetjen edhe të intelektualëve që vepronin jashtë hapësirave të Shqipërisë. (Njëherësh) Përveç shumicës myslimane, edhe të krishterët katolikë dhe ortodoksë kanë qenë pjesë e evenimentit të shpalljes së pavarësisë.

Gazeta Sabah, në numrin e datës 1 dhjetor 1912, në një kolumne me titull Shqipëria dhe Serbia, ndër të tjera shkruante: Pavarësia e Shqipërisë është mjaft e dyshimtë. Një qeverie të pavarur i duhen shumë para për të mbijetuar. Andaj, është një pikëpyetje e madhe se si do të sigurohen këto para për të mbijetuar kjo qeverie shqiptare. Njëherësh, edhe qeveritë e tjera të Ballkanit, të cilat sapo kanë dalë nga lufta për pavarësi, nuk do ta shohin me sy të mirë themelimin e një shteti të ri. Nuk mund as të mendohet për një marrëveshje paraprake të Ismail Qemalit me Malin e Zi dhe me Serbinë. Atëherë, akti i shpalljes së pavarësisë do të jetë shumë ngacmues (luftënxitës) për serbët dhe grekët. Shqiptarët kërkojnë të gjithë hapësirat e banuara me shqiptarë. Por që, edhe serbët edhe grekët do të kenë kërkesa të njëjta për disa vendbanime. /Telegrafi/



# Diçka befasuese po ndodh në Silicon Valley

*Po përballemi me një kufi të ri për zhvillimin njerëzor dhe nuk është koha për t'iu dorëzuar tundimit për të pasur frikë, duke u kthyer mbrapsht.*



Diçka befasuese po ndodh në Silicon Valley. Përplasja e ashpër për fatin e OpenAI përfundoi me kthimin e Sam Altman në rolin e CEO, por ajo që kemi parë ka një rëndësi shumë më të madhe: përshkruan sfidën e fortë, për të përcaktuar natyrën dhe perspektivat e inteligjencës artificiale. Prandaj është një pikë kthese në revolucionin teknologjik që i jep formë shekullit të 21-të dhe hyn edhe në jetën tonë.

Rreth një vit pas debutimit të ChatGPT, i cili e bëri universale qasjen në inteligjencën artificiale, dy qëndrime të kundërta mbi atë “çfarë duhet bërë tani” u përballën brenda OpenAI: nga njëra anë ata që duan të përshpejtojnë zhvillimin e tij sa më shumë të jetë e mundur, në mënyrë që të lejojë këtë teknologji futuriste të zgjidhë disa nga problemet më të mëdha të njerëzimit, dhe nga ana tjetër ata që preferojnë të përqendrohen tek shqetësimet rreth çështjeve të “sigurisë”, dhe për këtë arsye synojnë të ngadalësojnë ritmin.

Në krye të atyre që duan të ecin më shpejt është Sam Altman, 38 vjeç, ndërsa lideri i frontit kundërshtar është Emmett Shear, 40 vjeç, bashkëthemelues i Twitch, të cilin bordi i OpenAI do ta kishte dashur si pasardhës. Teza e Shear është se nëse shpejtësia e zhvillimit të inteligjencës artificiale (IA) tani është 10, ajo duhet të reduktohet në 1-2.

Ilya Sutskever, bashkëthemelues i OpenAI, qëndroi në mbështetje të Shear, dhe për këtë arsye kur bordi i kompanisë shkarkoi Altmanin, ishte teza e “ngadalësimit për arsye sigurie” ajo që mbizotëroi. Por revolta masive e menaxherëve dhe punonjësve të OpenAI – 700 nga 770, me një mobilizim pothuajse të paprecedentë në Silicon Valley – e përmbysi situatën, duke çuar në rikthimin e Altmanit dhe duke bërë që të mbizotërojë pozicioni i atyre që duan të ecin më shpejt. Deri në atë pikë sa vetë Sutskever ndryshoi mendim, duke nxituar për të mbështetur përsëri Altmanin.

Për të patur një ide mbi ndikimin e rezultatit të kësaj përplasjeje,

duhet mbajtur parasysh se Microsoft, i cili investoi 13 miliardë dollarë në OpenAI, ishte gati të merrte Sam Altmanin, dhe për këtë arsye do ta kishte bërë të vetën edhe qasjen e Altmanit, duke nënkuptuar se nuk i kishte dyshimet për çështjet e “sigurisë”. Drejtori i Përgjithshëm i Microsoft, Satya Nadella, ishte i qartë në zgjedhjen e tij: është koha për të përshpejtuar, jo për të ngadalësuar zhvillimin e inteligjencës artificiale.

Prandaj, kthimi i Sam Altmanit shënon një rezultat domethënës në lidhje me drejtimin që po mbizotëron në Silicon Valley. Dhe ndikimi në tregun global mund të jetë i rëndësishëm sepse ballafaqimi mbi shpejtësinë e rritjes së IA, fsheh një nivel të dytë përplasjeje: midis atyre investitorëve që favorizojnë mundësinë e të ardhurave marramendëse të krijuara sa më shpejt, për të optimizuar avantazhin ndaj konkurrencës, dhe atyre studiuesve që shohin me kini frikë nga zhvillimi i teknologjive, të cilat teorikisht

mund të eliminojnë lloje të tëra punësh si dhe të gjenerojnë sisteme që janë aq autonome, sa të mund t'i shpëtojnë çdo forme kontrolli nga cilido.

Por nuk është kjo e gjitha, sepse Larry Summers, ish-sekretari i Thesarit i Bill Clintonit, ish-drejtor i Këshillit Ekonomik Kombëtar të Barack Obamës dhe ish-riktor i Universitetit të Harvardit, qëndron në bordin e ri të OpenAI, së bashku me Sam Altman. Me pak fjalë, një nga emrat më të njohur në Wall Street, pavarësisht polemikave të së shkuarës së afërt për fyerjet ndaj grave.

Teza e Summers është që ChatGPT “ka mundësinë të krijojë terrene të reja lojërash” duke ripërcaktuar vetë idenë e fuqisë punëtore, sepse do të ndryshojë mënyrën se si mjekët bëjnë diagnoza, botuesit punojnë me libra dhe investitorët operojnë në tregje. Prandaj, ekziston një pikë takimi midis “përshpejtuesve” të Sam Altmanit dhe një prej mendimtarëve të pavarur më të njohur në Wall Street: po përballemi me një kufi të ri për

zhvillimin njerëzor dhe nuk është koha për t'iu dorëzuar tundimit për të pasur frikë, duke u kthyer mbrapsht.

Prandaj, tani mund të bëhemi dëshmitarë të një rritje të konkurrencës me OpenAI nga konkurrentët më të fortë në inteligjencën artificiale. Ashtu si Mustafa Suleyman, CEO i Inflection, i cili nxitoi të thoshte “Ejani të garoni me ne!”, apo “kryeshkencëtari i IA” tek kompania e Zuckerbergut, Meta, Yann LeCun, i sigurt se ekipi i tij do të befasojë të gjithë dhe do të mposhtë çdo rival. Për të mos përmendur Anthropic dhe Google, të cilët po ringjallin motorët e tyre me besimin se ajo që ndodhi brenda OpenAI shënon një pikë kthese pothuajse ideologjike për inteligjencën artificiale: sfida tani është harmonizimi i përshpejtimit dhe sigurisë, pa hezituar. Në pritje të debutimit të produkteve të reja “të pabesueshme” të Sam Altman, të cilat të gjithë i presin tani në Silicon Valley, siç ndodhi dikur për iPhone-ët e Steve Jobs. / la repubblica – bota.al



# RAMIZ CERNICA IDEOLOG I KOMBIT



Ismet SYLEJMANI

I dashur Daja Abdyl Hoxha, e nderuar familje e Ramiz Cernicës! Enderuara Nënkrjetare e Komunës znj. Leonora Morina!  
I nderuar Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit Kushtrim Zeqiri!  
Te dashura familje të Dëshmorëve të Kombit, të dashur invalid e veteran të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës!  
Të nderuar deputet te Kuvendit te Kosovës, i nderuar Deputet i Luginës, i nderuar Komandant i Zonës Ahmet Isufi, i nderuar Zv. Ministër i Mbrojtjes Shemsy Syla!  
Te nderuar te pranishëm të Cernicës, të Gjilanit, të Kosovës, të Luginës dhe të gjitha viseve shqiptare!

**Zonja dhe zotrinj!**

Kanë kaluar vite të tëra prej kur e kam dorëzuar për herë të parë kërkesën në emër të Kryetarit të Klubit Politik "Afrim Zhitia" për Sheshin dhe Shtatoren e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica në Gjilan!  
Por vetëm pas ardhjes në pushtet të Lëvizjes Vetvendosje, ia arritëm, vitin e kaluar, saktësisht më 25 Nëntor 2022, bashkë me Kryetarin e Gjilanit Alban Hysenin, bashkë me Udhëheqësin e popullit shqiptar Ali Ahmetin, bashkë me Dajen Abdyl Hoxha dhe të tjerë personalitete të shquara, hodhëm beton në gurethemel, dha ja sot një vit ma vonë, në ditën e Flamurit po e inaugurojmë shtatoren e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica!  
Gjilani sot është me i bukur se kurrë më parë në historinë e tij, Shtatorja e deputetit historik të popullit shqiptar Ramiz Cernica, ia ka shtuar hijeshinë, i jep shkelqim edhe më të madh!

Serbët antishqiptar vrasës, gjakpirës e kolonizator të Kosovës, që kanë sunduar në Gjilan, që kanë rrahur e torturuar, që kanë shetituar në qender të qytetit, në ketë shesh e në çdo skutë, që kanë thënë se Kosova është djep i Serbisë, si Toma Popoviq, Dushan Ristiç, Can Periq e tjerë, por edhe tradhëtar shqiptar në ballë me Ali Shukriun e klikën e tij, kudo që kalben në varreza serbe në Beograd e gjetiu, por edhe të vdekurit të gjallë, si ata, mbetje pushtuesish dhe tradhëtarësh, duhet ta dijnë, njëherë e përgjithmonë, se Anteu shqiptar i parlamentarizmit, Tribuni i Kuvendit të Kombit, 5 herë ish-burgosuri politik, Titani Ramiz Cernica, sot është inauguruar në përmendore bronzi dhe populli e kombi i përulet me respekt dhe e nderon me dashuri të madhe e mirënjohje të thellë!

**Motra dhe vëllezër,**

Para 78 viteve, në Korrik të vitit 1945, Heroi Legjendar i Kuvendit të

Kosovës në Prizren, Tribuni trim e sypatrembur Ramiz Cernica, me qëndrimin e Tij burrëror në mbrojtje të Kosovës, në Parlament, në rethem me kordon të hekurt ushtarako-politor të ushtrisë dhe policisë pushtuese Jugosllave, ia ka nderuar vetës së tij përmendoren në zemër të popullit, por edhe ia ka shkruar shtatin e Tij të derdhur në bronz!

Si anëtar në udhëheqje të lartë të Lëvizjes Popullore të Kosovës, si ushtarë i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i Ushtrisë Çlirimtare për Preshevë Medvegjë e Bujanov dhe Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, bashkë me shokë, bashkëveprimtar e bashkëluftëtarë, kemi pasur përgjegjësi të veçantë për të nderuar Heroin e Kuvendit të Kosovës, Simbolin e Bashkimit me Shqipërinë, Tribunin e Kombit Ramiz Cernica!

Ramiz Cernica ishte vazhduesi me besnik dhe kopja më origjinale e

brezave, në ballë të cilëve ishte Simboli i Rezistences Adem Demaçi, Çeliku i Qendresës, Heroi i Kombit Rexhep Malaj, Organizatori i famshëm i diasporës, Heroi i Kombit Kadri Zeka, deri te i fundit, Komandanti Legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës Adem Jashari! Dalëzotësin e Kosovës, birin besnik të saj, shqiptarin trim e të pamposhtur, Kryetarin Ramiz Cernica, i cili ishte ngritur si ortek gjigant dhe duke qenë Ai i pari dhe i vetmi që ua përplasi në surrat krimineleve serb dhe tradhëtarëve shqiptar në Kuvend të popullit në Prizren, se Kosova nuk dëshiron të jetë e ndarë nga Nëna e saj, ne pasardhësit e Tij besnik, e kemi kujtuar kurdoherë e në çdo rrethanë, sikur para luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ashtu edhe pas çlirimit nga Serbia pushtuese, por edhe pas Shpalljes së Pavarësisë të Kosovës!

Pjesën e parë të thënies së tij



ideologëve të kombit, Abdyl Frashëri, Hasan Prishtina e Ismail Qemali!  
Ramiz Cernica front final të kryeveprës së Tij dhe arenë gladiatorit e kishte Parlamentin e Kosovës dhe përfaqësonte trurin e Kombit, por edhe ishte pararoja e mendjendriturve të Atdheut, e atyre që më vonë u bënë frymzim i të tërë

gjeniale JO ME SERBINË, me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe me ndihmën e aleatit tonë të madh Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe NATO-s e kemi bërë realitet!  
Me gjeneratat që do të vijnë, do të vazhdojmë pjesën tjetër, PO ME SHQIPËRINË!  
Askush nuk mund të krahasohet me birin e madh, Udhëheqësin e



lavdishëm të popullit tonë, Simbolin e Bashkimit të Kosovës me Shqipërinë Nënë, Tribunin e Kombit Ramiz Cernica!

Si veprimtar e luftëtar kombëtar, si ushtarë çlirimtar, nuk mund të qëndrojmë duarkryq kur përballemi me tendenca inatesh e klanesh, ffishesh e familjesh, personalitetesh e profesioneesh, ngado që vijnë ato, për të mos ia dhënë vendin e merituar, në formë dhe përmbajtje, kudo e kujtëdo, e në mënyrë të veçantë mbrojtësit më të madh të Kosovës, politikanit e intelektualit popullor dhe ideologut kombëtar, Tribunin të Kombit Ramiz Ahmetit nga Cernica e Gjilanit!

Fjalimin e Tij programatik për bashkim të Kosovës me Shqipërinë, në Kuvendin e Kosovës në Prizren e kemi kujtuar dhe i kemi bërë jehonë kudo, dhe me vendosmëri e besnikëri të madhe kemi vepruar në nderim të aktit të Tij, që e ka bërë të paarrtshëm nga askush, edhe nga ata ia kanë kushtuar tërë jetën popullit, Atdheut dhe Kombit!  
Ne vazhduesit e idealeve të mëdha, nuk jemi mjaftuar vetëm me dëgjimin e tregimeve nga të parët tanë për burrin e madh Ramiz Cernicën, por kemi vepruar praktikisht, kemi përballuar çdo pengesë dhe kemi shpartalluar çdo bllokadë, dhe ja ku jemi sot, përballë shtatit të Tij të derdhur në bronz në Qytetin e Gjilanit, ku nuk sundon më çizmja pushtuese serbe dhe tradhëtarë, por as mbetjet e tyre!  
Kosova e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica, simbas parashikimit të Tij gjenial që në vitin e largët 1945 të shekullit të kaluar, tani është e lirë dhe e pavarur, është e njohur dhe e pranuar ndërkombëtarisht e me aleat të mëdhenj si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca, Italia dhe aleat të tjerë të rëndësishëm të veçantë kombëtare e ndërkombëtare!

Faleminderit i dashur dhe i nderuar Kryetar i Komunës së Gjilanit Alban Hyseni, qe e lejove ngritjen e shtatores se Ramiz Cernicës dhe vendosjen në vendin më të mirë, e më të rëndësishëm, para Komunës së Gjilanit, në rresht me Kryeheroin kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeun, dhe me simbolin e thyerjes se kufirit Kosovë – Shqipëri, Heroin e Kombit, Agim Ramadani!

**Të nderuar të pranishëm,**

Për Babain e Parlamentit të Kosovës, dhe birin e madh e besnik të Shqipërisë Ramiz Cernicën, unë sot kam katër propozime:

1. Ramiz Cernicës t'i ngritet Shtatorja para Parlamentit të Kosovës në Prishtinë!
2. Ramiz Cernicës t'i ngritet shtatorja para Parlamentit të Shqipërisë në Tiranë!
3. Gjymnazit në Prizren, ku është mbajtur Mbledhja e Kuvendit të Kosovës në vitin 1945, aty ku Deputeti i Popullit Ramiz Cernica, i ka vënë themelet e Kosovës JO ME SERBINË, t'i vëhet emri i Tij!
4. Para Gjymnazit "Ramiz Cernica" në Prizren të ngritet Shtatorja e Tij!


**Motra dhe vëllezër,**

Në këto momente feste, gëzimi e hareja që natyrshëm na vijnë: për ballë Intelektualit e strategut popullor; përballë Babait të Kuvendit të Kosovës; përballë Ideologut të Kombit; përballë Deputetit Legjendar të popullit shqiptar e Heroit të Kuvendit të Kosovës në Prizren, me përulje e me nderim, në emër të të gjithë brezave, stërgjyshërve e gjyshërve, nënave e baballarëve, në emrin e Klubit Politik "Afrim Zhitia", në emër të familjes time e në emrin tim, i thërrasim me gjithë fuqinë e zemrës, LAVDI RAMIZ CERNICA!

Gjilan, 28 Nëntor 2023!







Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Marathonomaku i 111-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë

Kampioni Erzen Zyberaj bëri historinë duke vrapuar plotë 260 kilometra nga Prishtina në Tiranë në kuadër të 111-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. "Historia u shkrua. Së bashku ia dolëm. Prishtinë-Tiranë 260km 28:20. Urime festa e 28 Nëntorit të gjithë popullit shqiptarë", ka thënë Zyberaj

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 28 NËNTOR - Nga Sheshi "Skënderbeu" në Prishtinë në Sheshin "Skënderbeu" në Tiranë vrapoi për nder të 111-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe gjithë atyre që flijuan jetën për liri, Erzen Zyberaj. Atleti i njohur bëri historinë duke arritur të vrapojë plotë 260 kilometra nga njëri kryeqytet shqiptar në tjetrin dhe në këtë mënyrë e realizoi ëndrrën e kamotshme. Vrapimi i Zyberajt ishte sa sfidues aq edhe emocionues ku u përkrah nga familjarët dhe miqtë e tij, por u nderua shumë edhe nga qytetarët e secilit qytet shqiptarë. Fillimisht në sheshin e Prishtinës, i pari i kryeqytetit Përparim Rama së bashku me drejtorin e sportit, Granit

Përparim Rama. Kushtet e vështira atmosferike nuk e penguan aspak kampionin me prejardhje nga Rahoveci që të arrijë synimin për të realizuar një udhëtim shumë sfidues, por në vazhdimësi ai u motivua nga ekipi përcjellës dhe qytetarët që e përshëndesnin dhe i uronin të mbarën gjatë gjithë rrugëtimit. Pas mesditës në ditën e martë, Zyberaj arriti në Tiranë ku është pritur nga shumë qytetarë të cilët e uruan për këtë arritje historike. Shteti shqiptar e nderoi Zyberajn me një medalje. Ai më këtë rast është pritur nga nënkryetari i Bashkisë së Tiranës Andi Seferi. "Jam shumë i lumtur për respektin nga Bashkia e Tiranës. Normalisht është sfidues shumë për shkak të kushteve klimatike që ndeshëm, por ia arritëm", ka deklaruar Zyberaj pas pranimit të medaljes. Zyberaj në orët e vona të së martës ka reaguar edhe më një postim të gjatë në "Facebook", ku pasi shprehi kënaqësinë e arritjes së një tjetër suksesi në karrierën e tij, falënderoi një nga një të gjithë ata që e ndihmuan në rrugëtimin historik.



Rugova dolën që ta përshëndesnin dhe t'i urojnë rrugëtim të mbarë kampionit Erzen Zyberaj. "I urova rrugëtim të mbarë atletit të pasionuar Erzen Zyberaj, i cili do të vrapojë nga Prishtina në Tiranë, duke përshkuar një distancë prej 260 km, për të nderuar Festën e Flamurit Kombëtar! Ky vrapim është një shprehje e vërtetë e dashurisë dhe respektit ndaj flamurit kombëtar. Atleti ynë po bënë një udhëtim të shkëlqyer për të sjellë bashkë me vete frymën e pavarësisë dhe lavdisë që flamuri simbolizon", ka deklaruar



"Historia u shkrua. Së bashku ia dolëm. Prishtinë-Tiranë 260km 28:20. Urime festa e 28 Nëntorit të gjithë popullit shqiptarë", ka thënë Zyberaj.



## Dukagjini regjistron fitore bindëse ndaj Fushë Kosovës

KLINË, 28 NËNTOR - Dukagjini ka shënuar fitore në ndeshjen e fundit të javës së 15-të në Albi Mall Superligë kundër Fushë Kosovës, me rezultat bindës 3-0. Kjo ndeshje e paraparë të

zhvillohej në fundjavë u shty për shkak të reshjeve të borës, teksa të martën u zhvillua në stadiumin "Sami Kelmendi" në Lipjan. Skuadra e drejtuar nga Armend Dallku e dominoi

ndeshjen që nga fillimi dhe si rrjedhojë realizoi tre gola. Rezultati u zhblllokua në minutën e 17-të, me golin e Blerind Morinës. Epërsinë në 2:0 e shtoi Bujar Shabani në

minutën e 49-të, derisa rezultatin e vulosi Altin Merlaku, në minutën e 82-të. Pas kësaj fitoreje Dukagjini mbetet në pozitën e gjashtë, me 20 pikë.





## Philadelphia dhe Denveri tregojnë forcën, bien Lakersat dhe Clippersat

**LOS ANXHELOS, 28 NËNTOR** - Mbrëmje spektakli dhe konfirmimesh në NBA. Mbi të gjithë Philadelphia dhe Joel Embiid zyrtarizojnë formën e shkëlqyer në këtë sezon të basketbollit amerikan, me një tjetër fitore të madhe. Sixers triumfuan me 44 pikë diferencë ndaj Los Angeles Lakers në

rezultatit e përgjithshëm 139-94. Embiid bëri një paraqitje fantastike të kurorëzuar me tre shifra dopjo 30 pikë, 11 topa në tabelë dhe po aq asist për shokët e skuadrës. Ashtu si rezultati, nën nivel ishte ndeshja e yjeve të Lakers, LeBron James dhe Anthony Davis. Vetëm 18 pikë për "The King" dhe 17 të tjera për

qendrën, që gjithashtu kapi edhe 11 topa në tabelë. Me këtë fitore, Philadelphia konsolidon vendin e dytë në renditjen e Konferencës së Lindjes, ndërsa Lakers renditen në tetët në Perëndim. Një mbrëmje të keqe jetoi edhe gjysma tjetër e Los Angeles, pasi Clippers u mundën nga Denver me rezultatit 104-113. Pa Jokic të

dëmtuar, rolin e liderit për kampionët në fuqi të NBA e mori Reggie Jackson, autor i dy shifrave dopjo me 35 pikë dhe 13 asist. Nga ana tjetër, për Clippers nuk mjaftoi paraqitja e Kawhi Leonard me 31 pikë dhe ajo e Rusell Westbrook sidomos në mbrojtje me 11 topa të kapur në tabelë. Në sfidat e tjera të



mbrëmjes, fitore të rëndësishme siguruan Utah Jazz, Washington dhe Portland.

## 'Dardanet' me optimizëm e presin duelin ndaj Bullgarisë

Prishtinë, 28 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në konkurrencën e femrave ka nisur përgatitjet për ndeshjen kundër Bullgarisë, në kuadër të Ligës së Kombeve, e cila zhvillohet më 1 dhjetor, në orën 13:00, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. Stërvitja e parë u zhvillua në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali në një mot tejet



të ftoftë dhe me reshje të shiut, por kjo nuk i pengoi futbollistet dardane që të punojnë me përkushtim nën urdhrat e përzgjedhës Anneli Andersen dhe stafit të saj. "Stërvitja e parë shkoi mirë. Moti për mua ishte i mirë sepse vij nga Suedia. Ishte kënaqësi të shihja vajzat duke u stërvitur. Natyrisht se të gjithë kanë dëshirë të luajnë në diell, por është përparësi pasi jemi përgatitur edhe për ndeshje me mot me shi. Kemi pasur rezultatet të mira. Kundër Bullgarisë të gjitha rezultatet janë të mundshme. Duhet të punojmë shumë sepse Bullgaria nuk është kundërshtar i lehtë. Ata kanë një ekip shumë të mirë. Sivjet jemi përballur katër herë me këtë kundërshtar dhe secila lojë ishte

më e vështirë se sa tjera. Siç i njohim ne, edhe ata na njohin neve, prandaj duhet të jemi sa më të përgatitur", ka theksuar pas stërvitjes përzgjedhësja, Anneli Andersen. Futbollistet Valentina Limani dhe Lumbardha Misini u shprehën të lumtura që sërish janë bashkë në ekipin kombëtar dhe shfaqën optimizmin e tyre për rezultat pozitiv kundër Bullgarisë. Fitorja në këtë takim ia mundëson Kosovës që të promovohet në Ligën B të Ligës së Kombeve. Në ndeshjen e parë të zhvilluar në Plovdiv, Kosova barazoi me Bullgarinë (0:0), derisa në dy ndeshjet me Maqedoninë e Veriut ka shënuar fitore (3:1 dhe 2:0). Stërvitjen e radhës Dardanet e zhvillojnë të mërkurën në Podujevë.

### Lista e futbollisteve

Besarta Leci – VfB Stuttgart  
Raimonda Spahiu – Mitrovica  
Alma Demiri – Koln II  
Edona Kryeziu – Mitrovica  
Rrezona Ramadani – Vllaznia  
Blerta Smaili – Sundsvall DFF  
Agnesa Gashi – Mitrovica  
Feride Gashi – Hajvalia  
Fatlinda Ramaj – Hajvalia  
Iliriana Vllaslija – Bromolla  
Gresa Berisha – Tirana  
Valentina Limani – Eintracht Frankfurt  
Lumbardha Misini – Hajvalia  
Albulena Guri – Hajvali  
Donjeta Halilaj – Besiktas  
Verona Berisha – Hajvali  
Egzonë Zeka – Mitrovicë  
Valentina Metaj – Elpidas Karditsas  
Venera Rexhi – Mallbackens IF  
Kaltrina Biqkaj – Mitrovica  
Modesta Uka – Sturm Graz  
Elizabeta Ejupi – Sunderland FC  
Erëleta Memeti – Hoffenheim

## Verstappen: Mbyllëm një sezon perfekt, dyshoj se mund ta përsëritim

**ABU DHABI, 28 NËNTOR** - Me Çmimin e Madh të Abu Dhabit në pistën e Yas Marina, u mbyll edhe botërori i vitit 2023 në Formula 1. Kampioni i shpallur prej disa javësh, Max Verstappen dominoi edhe në garën e fundit të sezonit duke triumfuar në Lindjen e Mesme dhe duke koleksionuar triumfin e 19 sezonal nga 22 gara në total. Një dominim total i holandezit dhe Red Bullit që mbyllin kështu një tjetër vit mjaft të suksesshëm. Pas garës Max Verstappen deklaroi se do të jetë e vështirë që të përsëritet një edicion si ky që u mbyll, duke e cilësuar të pabesueshëm për atë çka u regjistrua gjatë vitit 2023. "Një sezon i jashtëzakonshëm. Jam shumë krenar që fitova edhe në garën e fundit. Dua të falënderoj



Red Bull-in, pasi ka qenë një vit i jashtëzakonshëm. Do të jetë e vështirë të bëjmë diçka të ngjashme përsëri, por ne padyshim që e kemi shijuar këtë vit. Ne po punojmë shumë që vitin e ardhshëm të kemi sërish një makinë shumë konkurruese. Sigurisht që të gjitha skuadrat e tjera duan të përpiqen të na

mposhtin atje. Ne jemi gati për betejë, por ndërkohë do të shijojmë pak edhe këtë vit", ka thënë Verstappen. Verstappen arriti që të fitonte titullin e tretë botëror radhazi, teksa ai ka si objektivi që të barazohet me Lewis Hamilton dhe Michael Schumacher, të cilët kanë triumfuar nga 7 herë në garat me makina.

### SHKURT

#### Ballkani zhvillon stërvitje në Tiranë para duelit në Ligën e Konferencës

Skuadra e Ballkanit ka arritur në Tiranë dhe ka zhvilluar stërvitje para përballjes së të enjtes në Ligën e Konferencës. Kampioni i Kosovës do të përballlet me Viktoria Plzenin në "Air Albania", duke filluar nga ora 18:45, pasi stadiumi në Prishtinë nuk plotësoi kushtet për lojë. "Me këtë rast duam të falënderojmë klubin e futbollit Dimano City për mbështetjen që na kanë dhënë, ku edhe kemi zhvilluar një seancë stërvitore në kompleksin e tyre sportiv", thuhet në njoftim. "Ndeshja e pestë dhe më e rëndësishmja për ne deri tani në Grupin C të UECL-së, po afron, andaj ju ftojme të gjithëve nga krejt trevat shqiptare, të bashkohemi në stadiumin ikonik "Air Albania" për një tjetër festë futbolli kombëtar".

#### Dinamo Zagreb ofron dy milionë euro për Arbër Hoxhën

Sulmuesi nga Kosova, Arbër Hoxha është në "shënjestrën" e gjigantit kroat të futbollit, Dinamo Zagreb. Sipas raportimeve të "Index.hr", Dinamo Zagreb është në aksion për të transferuar Hoxhën nga Slaven Belupo. Klubi më i trofshëm i futbollit kroat është gati të ofrojë dy milionë euro për shërbimet e Arbër Hoxhës. Sipas Transfermarkt, Hoxha kap vlerën e 900 mijë eurove dhe prej kohësh është një nga sulmuesit më të mirë në kampionatin kroat. Madje, raportohet se Hoxha është dëshirë edhe e trajnerit të Dinamo Zagrebit, Sergej Jakiroviq. Hoxha këtë sezon ka 17 paraqitje në kampionat dhe në Kupë dhe ka shënuar katër gola me tre asistime në 1481 minuta lojë. Ai ka ardhur në Slaven në shkurt të vitit 2022 nga Ballkani, ndërsa para kësaj ka kaluar dy vite në Lokomotivë.


#### Khaka: Nder të punoj me një trajner si Xabi Alonso

Granit Khaka është bërë shumë shpejtë figura kryesore e Bayer Leverkusen në Gjermani, skuadër kjo e cila nuk nje humbje në Bundesligë, me 11 fitore dhe një barazim pas 12 ndeshjeve. Skuadra e cila drejtohet nga trajneri Xabi Alonso është në krye të tabelës me 34 pikë, dy më shumë se Bayern Munich. Duke folur për formën e skuadrës së tij, Khaka ka thënë se po kalojnë një moment shumë të rëndësishëm, por që ka kërkuar të mos ketë eufori brenda grupit. "Ne kemi një ekip të madh, një trajner të madh dhe një mentalitet të fortë. Nuk kemi fituar ende asgjë dhe duhet të vazhdojmë të punojmë. Le të shohim se ku do të përfundojmë", ka thënë kapiteni i Zvicrës për "Sky". Ai më pas ka thurur elozhe për trajnerin e tij, spanjollin Xabi Alonso nga i cili ka thënë se po mëson shumë. "Unë mësoj prej tij çdo ditë. Është shumë argëtuese. Ka qenë një lojtar i klasit botëror. Është si një ëndërr për mua të luaj nën drejtimin e tij".


#### Bayerni 'blindon' portierët Neuer dhe Ulreich

Bayern Munichu ka blinduar zyrtarisht dyshen Manuel Neuer dhe Sven Ulreich. Gjiganti Bavarezë këtë gjë e bëri përmes një komunikate, duke thënë se dy portierët do të vazhdojnë të jenë pjesë e tyre edhe për një sezon tjetër (2024/25). "Kapiteni Manuel Neuer, 37 vjeç dhe Sven Ulreich, 35 vjeç, kanë qenë mbështetja e fortë e FC Bayern për shumë vite – dhe do të vazhdojnë të jetë e tillë", thuhet fillimisht në njoftimin e tyre. "FC Bayern tani i ka zgjedhur dyja kontratat me nga një vit deri më 30 qershor 2025". Neuer sa është rikthyer nga lëndimi dhe vazhdon të jetë pika kryesore e ekipit, ndërsa Ulreich do të vazhdojë të jetë mbështetja e tij.






REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN



Bazuar në nenin 11 paragrafi 2, nenin 12 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit Nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike, nenin 3 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.03/2014 (MTI) për Procedurën Formën dhe Përbajtjen e Konkursit Kushtet dhe Kriteret për Vendosjen e Subjekteve Afariste Brenda Hapësirave të Zonave Ekonomike, Drejtorati Për Ekonomi dhe Zhvillim bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.15-300/01-61655 të datës 30.10.2023 për fillimin e procedurave për shpalljen e konkursit për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qytagë - faza e dytë, Komuna e Lipjanit, shpallë:

**KONKURS PUBLIK**

**PËR VENDOSJE TË BIZNESEVE NË PARKUN INDUSTRIAL NË QYTAGË - FAZA E DYTË**

**Vendndodhja:** Fshati QYTAGË Komuna e Lipjanit, kilometri i 10-të në rrugën rajonale Lipjan-Sllatinë.

**Numri i parcelave të lira:** 2 parcela.

**Sipërfaqja:**

- P-71409090-00476-4 – 17698 m<sup>2</sup>
- P-71409090-00476-5 – 9433 m<sup>2</sup>

**Veprimtaritë e lejuara në parkun industrial:** Në parkun industrial mund të zhvillohet çdo veprimtari afariste e cila nuk çënon rendin publik, mbrojtjen e shëndetit publik, mjedisin, florën dhe faunën si dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

**Përparësitë për vendosje në parkun industrial:** Me rastin e shqyrtimit të aplikacioneve përparësi do të kenë ato biznese të cilat merren me veprimtari prodhuese, përpunimi të produkteve si dhe impakti i tyre në rritjen e punësimit.

**E drejta e aplikimit:** Të drejtë aplikimi kanë të gjitha bizneset vendore dhe të huaja të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret që janë të përcaktuara në këtë konkurs, që kanë për qëllim zhvillimin dhe zgjerimin e kapaciteteve biznesore dhe rritjen e zhvillimit ekonomik.

**Informata Promovuese:**

- Pozitë e përshtatshme gjeografike në raport me Kryeqytetin dhe me qytetet fqinje, shtrihet në km e 10 nga qendra Komunale, 7 km nga Aeroporti,
- Ekzistimi i Zonave të veçanta (Zona e Blinajës, Shpella e Gadimës, Zona Kleqkë dhe Divjakë),
- Buxhet i qëndrueshëm i qeverisë lokale,
- Sektori bankar i zhvilluar,
- Traditë industriale (Miniera industriale e Magnezitit - Golesh, nxirrja e lëndës së parë për Feroniklin, përpunimi i grurit, drurit, plastikës dhe fryteve të natyrës)
- Tregti dhe Shërbime të Zhvilluara,
- Procedurat e thjeshta lokale për biznese,
- Ekzistimi i resurseve për energji alternative,
- Kapacitete njerëzore, humane dhe përgatitja profesionale e tyre,
- Staf i kënaqshëm i profileve të ndryshme,
- Qasje e afërt me autostradat kryesore,
- Aktivitetet e lartë në industrinë e ndërtimit,
- Kushte të favorshme për dhënie në shfrytëzim për ndërtim të aktiviteteve ekonomike

**Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:** Me rastin e aplikimit për të u vendosur në park industrial të interesuarit duhet dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i plotësuar me të dhënat e kërkuara
- Certifikata e regjistrimit të biznesit
- Historiati i kompanisë (biznesit)
- Veprimtaria që do ta zhvilloj
- Projekti ideor
- Fletëpagesën (merret tek Qendra për Shërbim me Qytetarë)

Bizneset e aprovuara në parim brenda afatit kohorë prej 30 (tridhjetë) ditësh duhet të sjellin dokumentacionin si në vijim:

- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës për përmbushjen e obligimeve tatimore
- Dëshminë nga ATK për numrin aktual të të punësuarve
- Planin e Biznesit

**Kriteret për vlerësim:**

- Punësimi 40 pikë
- Vlera investive 30 pikë
- Lloji i veprimtarisë 30 pikë

- Prodhuese 30 pikë,
- Përpunuese 20 pikë,
- Shërbyese 10 pikë

**Afati i dhënies në shfrytëzim** – nëntëdhjetë e nëntë (99) vite nga dita e nënshkrimit të kontratës.

**Tërheqja e formularit:**

Formulari për aplikim mund të merret në zyrën pritëse të komunës (Qendrën për Shërbim me Qytetarë) – kati përtheshë çdo ditë pune nga ora 8:00 deri në ora 16:00, ose në faqen zyrtare të komunës.

**Dorëzimi i dokumentacionit:**

Formulari i plotësuar së bashku me dokumentacionin tjetër të kërkuar me konkurs duhet dorëzuar në mënyrë fizike në zyrën pritëse të komunës (në pliko të mbyllura të vulosura me vulën e biznesit), i cili i adresohet Komisionit për Vlerësimin e Ofertave dhe për Zbatim të Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës për ZE Qytagë.

**Afati i për aplikim:** Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Lipjanit.

**Informatë shtesë:** Bizneset të cilat do të përzgjidhen konform procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore në tri (3) vitet e para nga dita e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas tri viteve do të paguajnë si në tabelën më poshtë.

Vitet e Operimit	Çmimi për m2 – Në vit	Çmimi për 1 Ha – Në vit
Në 3 (tri) vitet e para	0.00 euro	00.00 euro
Prej vitit të 4 (katërt) deri në vitin e 7 (shtatë)	0.07 euro	700.00 euro
Prej vitit të 8 (tetë) deri në vitin e 10 (dhjetë)	0.11 euro	1,1000.00 euro
Prej vitit 11 (njëmbëdhjetë)	0.125 euro	1.250.00 euro

**Aplikuesit, në momentin e konkurimit në pajtim me Rregulloren për Taksa Komunale duhet të paguajnë taksën në shumë prej 100 € ( njëqind euro) për aplikim, ndërsa për secilin aplikim nevojitet pliko ose zarfë i veçantë, dhe jashtë kuvertës në njërën anë duhet të shënohet: ---- Parku Industrial, Qytagë FAZA II----**

**Vërejtje:** Aplikacionet e dorëzuara pas ditës së mbylljes së konkursit nuk do të merren në shqyrtim përveç atyre që arrijnë përmes postës të cilat mbajnë datën e fundit të caktuar në konkurs deri në ora 16:00.

**E drejta në ankesë:** Bizneseve të cilave iu refuzohet e drejta për të u vendosur në parkun industrial kanë të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave brenda afatit prej 8 ditë pune.

Drejtor për Ekonomi dhe Zhvillim

Valon Pacolli

**>> SHPALLJE TË VOGLA <<**

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.









REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT  
REPUBLIKA KOSOVA  
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me:  
Primljeno: 27.11.2023

Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
07-462/01-65675		



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

Osnivajući se u članu 11 stav 2, člana 12 stava 1,2 i 3 Zakona Br. 04/L-159 za ekonomske zone, člana 3 stava 2 Administrativno Uputstvo Br.03/2014 (MTI) za Proceduru i Način i sadržinu Konkursa Uslovi i Kriterijumi za postavljanje poslovnih subjekata unutar prostora ekonomske zone Direktorat za Ekonomiju i Razvoj osnivajući se na Odluku Skupštine Opštine Br.15-300/01-61655 dt. 30.10.2023 za početak procedure za objavljivanje konkursa za postavljanje biznisa u ekonomskim zonama "Parku Industrial" u KZ Qylagë – Druga faza , Opština Lipjan , objavljuje:

### JAVNI KONKURS

#### ZA POSTAVLJANJE BIZNISA U INDUSTRIALNOM PARKU QYLAGË – DRUGA FAZA

Mesto: Selo QYLAGË Opština Lipjan, na desetom kilometru i 10-om rajonalnim putem Lipjan-Sllatino.

Broj slobodnih Parcela : 2 parcela.

Površina :

1. P-71409090-00476-4 – 17698 m<sup>2</sup>
2. P-71409090-00476-5 – 9433 m<sup>2</sup>

**Dozvoljene delatnosti u industriskom parku:** U industriskom parku može se odvijati svako poslovno delovanje koje ne ugrožava javni red, zaštitu javno zdravlje, sredinu, floru i faunu i ne dolazi u sukob sa zakonima.

**Prednosti za postravljanje u Përparësitë për vendosje u industriskom parku:** Tokom razmatranja aplikacija prednost imaju one biznisi koje se bave proizvodnjom preradu produkta i njihovo uticanje u zapošljavanju.

**Pravo apliciranja:** pravo na apliciranje imaju svi unutrašnji i spoljni biznisi koji ispunjuju uslove i kriterijume koji su određene u konkursu, koji imaju za nameru razvoj kapaciteta proširenje biznisa i ojačanje ekonomsko ojačanje.

#### Promoviranje informacije:

- Povoljna geografsko pozicija sa glavnom gradu i sa susednim gradovima , nalazjenje u 10 – om km od centra Opštine i , 7 km od Aeroporta,
- Ekzistencija posebnih zaona ( Zona Lipovice, Pečina u Gadimlje, Zona Kleqkë i Divjakë),
- Održivi budžet lokalne vlasti,
- Razvijen Bankarski Sektor,
- Industriska tradicija (industriski rudnik Magnezita - Golesh, površinski kop r Feronikla, prerada pšenice, drva, plastike i prirodnih voća)
- Trgovina i razvojne usluge,
- Lokalne Proste Procedure za biznis,
- Postojenje resurse za alternativnu energiju,
- Ljudske Kapaciteti, humane i njihovo profesionalne spreme ,
- Dovoljan razni profesionalni Staf ,
- Lak pristup u glavnim autoputu ,
- Visok Aktivnost u građevinskom industriji,
- Povoljne uslove za davanje na korišćenje i izgradnju ekonomske aktivnosti,

**Potrbna Dokumentacija za aplikaciju:** povodom apliciranja da se postave u industriskom parku zainteresovani treba da dostave ove dokumente:

- Popunjeni Formular sa traženim podacima
- Certifikat registracije biznisa
- Historiat kompanije (biznisa)
- Delatnost koju će razvija
- Idejni Projekat
- Uplatnicu (uzima se u centru za usluge za građane)

Usvojeni Biznisi treba da u roku od 30 (trideset) dana dostave sledeću dokumantaciju:

- Potvrdu Poreske Uprave Kosova za ispunjenje porezskih obaveza
- Potvrdu od ATK za broj zaposlenih
- Plan Biznisa

#### Kriterijumi za procenjivanje:

- Zapošljenje 40 poena;
- Vrednost investicija 30 poena;
- Vrsta delatnosti 30 poena;

- Proizvodne 30 poena,
- Preradu 20 poena,
- Uslužne 10 poena,

Rok davanja na korišćenje – devedeset devet (99) godina od dana potpisivanja ugovora.

#### Uzimanje formulara:

Formular za aplikaciju uzima se u kancelariju za građane u Opštini (Centar za usluge za građane) – Prizemlje svakog dana od 8:00 do 16:00, časova ili u službenom sajtu opštine.

#### Dostava dokumentacije:

Popunjeni formular zajedno sa ostalom traženom dokumentacijom u konkursu treba dostaviti fizički u kancelariju za dostavu u Opštini (u zatvorene pliko i uverene sa pečatom biznisa), koji se uputi Komisiji za procenjivanje ponuda i za sprovođenje procedure za davanje na korišćenje nepokretne imovine Opštine za EZ Qylagë.

**Rok Aplikacija :** Konkursje otvoren 30 dana od dana objavljivanja u službenom sajtu Opštine Lipjan.

**Dodatne informacije:** Biznesi koji će se odabrati u skladu sa određenim procedurama sa Zakonskim stavovima tri (3) prve godine od dana potpisivanja Ugovora sa Opštinom neće plaćati kompenzaciju dok nakon tri godine platiće sledeću sumu kao u tabeli.

Godine delovanja	Cena m <sup>2</sup> - Godišnje	Cena za 1 Ha - Godišnje
U 3 (tri) prve godine	0.00 euro	00.00 euro
Od 4 (četvrte) do 7 (sedme) godine	0.07 euro	700.00 euro
Od 8 (osme) do 10 (desete)	0.11 euro	1,100.00 euro
Od 11 (jedanaeste)	0.125 euro	1.250.00 euro

**Aplikanti od momenta konkurisanja u skladu sa Uredbom za Opštinske Takse treba da plate taksu u iznosu od 100 € ( sto euro) za aplikaciju, dok za svaku aplikaciju treba poseban pliko zarfa , i van koverte po strain treba se navesti :**

--- Parku Industrial, Qylagë, FAZA II ---

**Opomena :** Aplikacije dostavljene nakon dana zatvaranja konkursa neće se uzeti na razmatranje osim onih koje dolaze preko pošte i nose datum zatvaranja konkursa do 16:00 časova .

**Pravo žalbe :** Biznesima kojima je odbijena pravo da se postave u industriskom parku imaju pravo žalbe u Komisiju za žalbe u roku od 8 radnih dana .

Valon Pacolli – Direktor za DPZ

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS  
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE  
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : LIPJAN  
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Qylagë


Njësia/Jednica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m <sup>2</sup>
P-71409090-00476-5	Parcelë / Parcela / Parcel	9443
P-71409090-00476-4	Parcelë / Parcela / Parcel	17698

Shkalla/Razmera/Scale: 1:1664

Puno/Obradio/Created:  
Data/ Data/Date: 21.11.2023  
Koha/ Vreme/ Time: 11:18:05  
Nënskrimi/Potpis/Signature:  
Shënim/Beleška/Note:

Aprovo/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director



  
**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*  
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

**CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE**

---

**NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409090-00476-5**

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 1743/2023  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 27.09.2023 - 09:44  
Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Qylagë / Cuculjaga / Qylagë  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

**A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA**

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409090-00476-5	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	9443		14.06.2022	05.07.2022

**A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS**

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRÇEVA			14.06.2022	05.07.2022

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Visar.Bikliqi | P-71409090-00476-5 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person 1/2


**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Industri/Industrija/Industry	Repart prodhues/Proizvodni pogon/Production unit		9443

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1		17.06.2022

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Visar.Bikliqi | P-71409090-00476-5 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person 2/2

  
**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /*  
*Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*  
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

**CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE**

---

**NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71409090-00476-4**

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 1743/2023  
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 27.09.2023 - 09:44  
Komuna / Opština / Municipality: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN  
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Qylagë / Cuculjaga / Qylagë  
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: LIPJAN / LIPLJAN / LIPJAN

**A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA**

Numri i njësies kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit No.	Lloji i njësies Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71409090-00476-4	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	17698		14.06.2022	25.07.2023

**A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS**

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
KRÇEVA			14.06.2022	25.07.2023

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Visar.Bikliqi | P-71409090-00476-4 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person 1/2

**A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE**

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m <sup>2</sup> )
1	Industri/Industrija/Industry	Repart prodhues/Proizvodni pogon/Production unit		17698

**B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR**

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Përshkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	Komuna e Lipjanit	600371588	///		SHQIPËRIA	1/1		17.06.2022

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Visar.Bikliqi | P-71409090-00476-4 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person 2/2



